

TË RINJTË NË SHQIPËRI



RAPORTI DHE INDEKSI I VLERËSIMIT

për vitet 2015-2017

i zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për
Rininë në Shqipëri (2015-2020)

Tiranë, Gusht 2018

© Ky botim i CRCA Shqipëri mund të citohet, fotokopjohet apo printohet, por gjithnjë duke dhënë referencën përkatëse për autorët dhe organizatën. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të shitet apo botohet pa lejen me shkrim të CRCA Shqipëri. Opinione, mendimet, pikëpamjet dhe informacioni i dhënë në këtë botim jo detyrimisht shprehin opinionet, pikëpamjet apo qëndrimet e CRCA Shqipëri apo ato ANYN.



Raporti u përgatit nga:

Altin HAZIZAJ

Klaudio PULAHA

Referenca e botimit: Të Rinjtë në Shqipëri: Raporti dhe Indeksi Kombëtar i Vlerësimit për Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë në Shqipëri, CRCA Shqipëri, 2018.

© CRCA Shqipëri 2018

FALENDERIME

CRCA Shqipëri dhe Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri kanë kënaqësinë që të falenderojnë të gjithë të rinjtë dhe organizatat rinore që u bënë pjesë e procesit të përgatitjes së raportit të parë të monitorimit të zbatimit të Planit Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri (2015-2020).

Përgatitja e këtij raporti është e një rëndësie të veçantë për Shqipërinë dhe për lëvizjen rinore në vendin tonë. Është hera e parë që lëvizja rinore bëhet së bashku, me qëllim për të monitoruar dhe vlerësuar punën e institucioneve publike në nivel qendror dhe vendor, për të rinjtë dhe impaktit që politikat shtetërore kanë patur tek të rinjtë dhe lëvizjen e tyre në Shqipëri. Në këtë aspekt eksperiencia e përditshme e organizatave dhe përballja e tyre me institucionet publike, përbëjnë një eksperience e cila ka nevojë të matet dhe vlerësohet.

Ky raport monitorimi dhe indeksi që shoqëron atë, ndihmojnë për të kuptuar se cilat janë fushat ku politikat shtetërore ka nevojë të përmirësohen dhe forcohen në zbatim dhe cilat janë fushat ku ka arritje.

CRCA Shqipëri dhe Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri, duan të falendrojnë në mënyrë të posaçme z. Altin Hazizaj për përgatitjen e këtij raporti dhe z. Klaudio Pulaha për të gjithë punën përgatitore dhe krijimin e një mjedisi bashkëpunues dhe pjesmarrës për të gjitha organizatat e shoqërisë civile dhe forumet politike që punojnë për të rinjtë në Shqipëri.

Qëllimi i këtij Raporti dhe Indeksit shoqëruar shtrihet në disa plane. Së pari, ai kërkon të informojë të rinjtë, publikun dhe institucionet shtetërore në Shqipëri mbi situatën e të rinjve dhe të rejave në Shqipëri dhe problemet e identifikuar në zbatimin e PKVR-së, shkaqeve dhe dobësive të vërejtura në drejtim të mos-arritjes së objektivave të tij, brenda shtrirjes kohohe të parashikuar nga Qeveria shqiptare.

Së dyti, ai kërkon të angazhojë në një dialog të qendrueshëm, Qeverinë, Bashkitë dhe institucionet shtetërore që punojnë për të rinjtë, Kuvendin e Shqipërisë dhe organizatat që përfaqësojnë të rinjtë dhe interesat e tyre, në një proces që nxit pjesëmarrjen dhe vlerësimin për të rinjtë, analizën e politikës shtetërore, vendosjen e burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për zbatimin e Planit, që së bashku nxisin avancimin e të rinjve dhe të të drejtave të tyre në Shqipëri. Së treti, Raporti kërkon të krijojë një klimë ku organizatat e shoqërisë civile bëhen së bashku dhe rrisin nivelin e llogaridhënies së institucioneve publike përkundrejt qytetarëve të saj, përfshi të rinjtë.

Ne besojmë, se ky Raport dhe Indeksi i tij janë një mjet për të rritur përgjegjshmërinë e Qeverisë shqiptare dhe institucioneve të saj përkundrejt të rinjve në Shqipëri. Në këtë aspekt ne nxitim çdo organizatë rinore dhe çdo të ri në Shqipëri që ta përdorin këtë raport për të sjellë një ndryshim të prekshëm në jetën e tyre.

Raporti u përgatit në bashkëpunim me:

CRCA Shqipëri dhe Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri falenderojnë organizatat, grupimet dhe rrjetet e mëposhtme, të cilat kontribuan në mënyrë aktive në përgatitjen e këtij raporti:



PËRMBAJTJA

FALENDERIME	3
1. Hyrje	8
2. Kush konsiderohet i ri në Shqipëri?	10
3. Pse një Plan Kombëtar Veprimi për Rininë në Shqipëri?	11
4. Metodologjia	13
4.1 Instrumenti	13
4.2 Procesi, hapat dhe organizatat që u bënë pjesë e Raportit të Vlerësimit për të Rinjtë	14
4.3 Trajnimi i organizatave rinore dhe fokus grupet me të rinjtë dhe të rejtat	15
4.4 Kufizimet e Raportit	15
5. Të rinj të Harruar? Të dhëna për të rinjtë në Shqipëri	17
6. Indeksi Kombëtar i zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë (2015-2020)	26
7. Gjetjet dhe rekomandimet kryesore të Raportit dhe Indeksit Kombëtar i Vlerësimit	31
7.1 Gjetjet më kritike	31
7.2 Rekomandimet kryesore.....	34
8. Raporti i detajuar i vlerësimit të zbatimit të PKVR 2015-2017	36

Referenca

Lista e Shkurtimeve

ANYN	Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri
BE	Bashkimi Europian
CRCA	Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri
CoE	Këshilli i Europës
EUROSTAT	Instituti i Statistikave të Bashkimit Europian
GDP	Prodhimi i përgjithshëm bruto
INSTAT	Instituti i Statistikave (Shqipëri)
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
PKVR	Plani Kombëtar i Veprimit për të Rinjtë
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Lista e Grafikëve

Grafik 1: Popullsia e të rinjve në Shqipëri (2014-2018)

Grafik 2: Përqindja e popullsisë që zenë të rinjtë në Shqipëri

Grafik 3: Popullsia e të rinjve sipas gjinisë

Grafik 4: Martesat tek të rinjtë (2014-2017)

Grafik 5: GDP e vërtetë e Shqipërisë krahasuar me mesataren e BE-së

Grafik 6: Të regjistruar në total në arsim (15 vjec +)

Grafik 7: Të regjistruar në arsimin e mesëm dhe të lartë sipas viteve

Grafik 8: Të rinj të diplomuar në nivele të ndryshme të arsimimit (15+)

Grafik 9: Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15-29 vjeç)

Grafik 10: Origjina e vendeve të azil-kërkuesve në BE, 2016 dhe 2017

Grafik 11: Vendet kryesore të BE-së ku azil-kërkuesit nga Shqipëria kërkojnë azil për herë të parë, 2017

Grafik 12: Numri i emigrantëve, imigrantëve dhe migracioni neto në Shqipëri, 2011-2017

Grafik 13: Ndarja e të dënuarve sipas moshës, 2013-2017

Grafik 14: Numri i të dënuarve të rinj, 2013-2017

Grafik Nr.15: Vlerësimi i të rinjve për punën e Qeverisë dhe bashkive për zbatimin e Objektivit specifik 1.1

Grafik Nr.16: Vlerësimi i të rinjve për punën e Qeverisë dhe bashkive për zbatimin e Objektivit specifik 1.2

Grafik Nr.17: Vlerësimi i të rinjve për punën e Qeverisë dhe bashkive për zbatimin e Objektivit specifik 1.4

Grafik Nr.18: Vlerësimi i të rinjve për punën e Qeverisë dhe bashkive për zbatimin e Objektivit specifik 2.3

Grafik Nr.19: Vlerësimi i të rinjve për punën e Qeverisë dhe bashkive për zbatimin e Objektivit specifik 2.6

Grafik Nr.20: Vlerësimi i të rinjve për punën e Qeverisë dhe bashkive për zbatimin e Objektivit specifik 3.1

Grafik Nr.21: Vlerësimi i të rinjve për punën e Qeverisë dhe bashkive për zbatimin e Objektivit specifik 3.4

Grafik Nr.22: Vlerësimi i të rinjve për punën e Qeverisë dhe bashkive për zbatimin e Objektivit specifik 5.2

Grafik Nr.23: Vlerësimi i të rinjve për punën e Qeverisë për monitorimin dhe vlerësimin e PKVR

1. Hyrje

Në 6 Maj 2015, Qeveria Shqiptare miratoi Planin Kombëtar të Veprimit për të Rinjtë¹ (2015-2020), pas një përpjekje të gjerë të konsultimit me organizatat dhe të rinjtë në Shqipëri. Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri (*nëpërmjet LiderShipit për të Rinjtë në Tiranë*) luajti një rol aktiv në përgatitjen, rishikimin dhe konsultimin e Planit të Veprimit me të rinj e të reja dhe organizatat anëtare të saj.

Në vitin 2014, Qeveria² kishte filluar përgatitjet me pjesëmarrjen e gjerë të ministrive të linjës dhe OSHC-ve, Planin Kombëtar të Veprimit për të Rinjtë (2015-2020). Plani caktoi një sërë detyrash për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, institucionet në varësi të saj, ministrinë e tjera të linjës dhe bashkitë, të cilat janë përgjegjëse për arritjen e objektivave të tij.

Besohet se mëse 12 mijë të rinj anëmbanë vendit morën pjesë dhe kontribuan në përgatitjen e këtij dokumenti politik dhe strategjik. Në seancën e prezantimit të Planit me shumë fanfarë dhe nën prezencën e gjerë të mediave, të rinjve dhe trupit diplomatik, Plani Kombëtar krijoi pritshmërinë se brenda një kohe të shkurtër, falë mbështetjes së Qeverisë dhe Ministrisë së Mirëqenies dhe Rinisë, gjendja e të rinjve do të shihte një ndryshim drastik dhe se kjo politikë e re kombëtare, tashmë e buxhetuar, ishte mjeti për të shpënë përpara një ndër grupet më të harruara dhe të neglizhuara të shoqërisë, të rinjtë.

Tashmë Plani bën 3 vjet që nga fillimi i zbatimit të tij. Një Plan Veprimi, sado i mirë që të jetë, asnjëherë nuk iu garanton përfituesve të tij, se do të zbatohet. Ndonjëherë qeveritë krijojnë plane ambicioze apo jo reale, qëllimet e të cilave asnjëherë nuk arrihen, por ato duken mirë në sytë e publikut dhe përfituesve. Po ashtu ndodh që, pavarësisht qëllimeve të mira apo objektivitetit të tyre, planet nuk përkthehen në veprime konkrete për të sjellë ndryshim, pasi ato nuk marrin burimet e nevojshme financiare apo njerëzore, që kërkohen për zbatimin e tyre.

Çdo Qeveri ka për detyrë të raportojë për zbatimin e politikave të tyre në mbështetje të grupeve shoqërore. Por këto raporte nuk janë asnjëherë të pavarura dhe gjithnjë ekziston mundësia që ato të pikturojnë një botë “rozë”, kur në fakt gjendja e të rinjve nuk është përmirësuar apo nuk ka ndryshuar. Në këtë drejtim Raportet e Monitorim/Vlerësimit të përgatitura nga të rinjtë dhe të rejat dhe organizatat e tyre, janë mjeti që mobilizon shoqërinë civile për të dhënë mendimin e saj sa më të pavarur dhe sa më objektiv që është e mundur, për të evidentuar fushat dhe objektivat ku Qeveria dhe institucionet e saj nuk kanë punuar mjaftueshëm apo që duhet t’i kushtojnë më shumë burime, për të sjellë ndryshimin që pritet.

CRCA Shqipëri dhe Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri (ANYN) në vijim të miratimit të Planit i fokusuan përpjekjet e tyre në monitorimin e zbatimit të tij dhe angazhimin gjithnjë e më të gjerë të të rinjve dhe organizatave të tyre në avokatinë për zbatimin e përgjithshëm të objektivave dhe aktiviteteve të parashikuara në të.

¹ VKM 383, i datës 6.05.2015

² VKM 204, i datës 25.08.2014, “Për ngritjen e grupit ndërmësor të punës përgjegjës për bashkërendimin, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë, 2014 – 2020.

Përgatitja e një Raporti Vlerësimi është një ndërmarrje e vështirë për çdo rrjet organizatash. Falë eksperiencës dhe ekspertizës mbi 20 vjeçare të organizatave partnere të Rrjetit Kombëtar të Rinjve në Shqipëri, në fund të vitit 2016, CRCA Shqipëri dhe ANYN hapën një proces të gjerë konsultimi dhe mbledhje informacioni në lidhje me zbatimin e politikës kombëtare të Qeverisë për të rinjtë. Prosesi u shoqërua me shpërndarjen në rrugë zyrtare të pyetësorit për organizatat dhe institucionet, të cilave iu kërkua që ta plotësonin atë në kuadër të përgatitjes së Raportit.

Siç do të shpjegohet më gjerë tek kapitulli i metodologjisë, pyetësori përmbante një listë të gjatë pyetjesh dhe mundësish vlerësimi (nga 1 tek 10) mbi zbatimin e çdo objekti madhor dhe specifik, si dhe aktiviteteve që përmban Plani Kombëtar i Veprimit dhe që duhet të ishte përmbushur deri në fund të vitit 2017.

Në vijim të përgatitjes së Raportit një *retreat* dy ditor u organizua nga ANYN në Durrës, me organizatat anëtare të saj, për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe aspekteve më të rëndësishme të vlerësimit të zbatimit të Planit Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri. Pjesë e konsultimit u ftuan të bëhen jo vetëm OJF-të, por edhe forumet politike rinore, pasi shpesh roli i tyre në nxitjen e pjesmarrjes aktive të të rinjve në vendim-marrje neglizhohet. Përgjatë vitit 2017, të rinjtë dhe organizatat e tyre përgatitën një bazë të mirë vlerësimi dhe rekomandimesh që janë bërë pjesë e këtij Raporti dhe indeksit të zbatimit. Përgjatë 6 mujorit të parë të vitit 2018, ekspertët që u bënë pjesë e këtij procesi, vijuan me shkrimin e raportit, konsultimin me dokumentat zyrtare dhe buxhetin e shtetit, konsultimet me të rinjtë e të rejtat për pjesë specifike të raportit etj.

Në të njëjtën kohë iu kërkua Ministrisë përgjegjëse që të vinte në dispozicion çdo raport monitorimi dhe vlerësimi të bërë nga ana e departamenteve të saj, për të vëzhguar me këtë rast mënyrën sesi kishte funksionuar mekanizmi i monitorim-vlerësimit, si dhe gjetjet dhe rekomandimet e bëra pas çdo raporti. Deri në momentin e finalizimit të këtij raporti as CRCA-së dhe as ANYN-it nuk iu vendosën në dispozicion asnjë raport monitorimi apo vlerësimi në lidhje me PKV-në për Rininë.

Qëllimi kryesor i këtij Raporti është që të krijojë një proces të qendrushëm të monitorimit dhe vlerësimit të performancës së Qeverisë Shqiptare dhe institucioneve të saj në lidhje me arritjen e objektivave për të rinjtë; impaktit që politika kombëtare për të rinjtë ka patur në nivel kombëtar dhe lokal si dhe ndryshimeve që ajo ka sjellë në jetën e të rinjve anembanë Shqipërisë, kjo e shoqëruar me rritjen e pjesëmarrjes aktive të vetë të rinjve në këtë proces fuqizues demokratik dhe qytetar.

2. Kush konsiderohet i ri në Shqipëri?

Shqipëria, në krahasim me vendet e tjera evropiane, vazhdon të mbetet një vend me moshë mesatare relativisht të re, ku rreth 25% e popullatës dominohet nga mosha 15-29 vjeç, duke përbërë grupimin më të madh të forcës aktive në shoqëri dhe forcës së aftë për punë³.

Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011 regjistroi 2.8 milion banorë në Shqipëri, ku numri i të rinjve të grupmoshës 15-29 vjeç u llogarit në 704 mijë, duke përfaqësuar vetëm një të tretën (25,2 përqind) e të gjithë popullsisë. Me rreth 363 mijë djemve të grupmoshës 15-29 vjeç kundrejt rreth 342 mijë vajzave të kësaj grupmoshe, meshkujt me 51,5 përqind janë vetëm pak më shumë të përfaqësuar mes të rinjve krahasuar me të gjithë popullsinë. Mbipërfaqësimi më i madh i djemve është në grupmoshën 20-24 vjeç (52,6 përqind kundrejt 47,4 përqind vajza)⁴. Rinia, vuan shkallën më të lartë të papunësisë nga të gjithë grupmoshat. Shkalla e papunësisë ndërmjet të rinjve, duke iu referuar të dhënave nga INSTAT, për grupmoshën 15-29 vjeç është 30.2 % nga ku 33 % janë djem dhe 25.4% janë vajza⁵.

Shqipëria nuk ka një ligj për të rinjtë. Për këtë shkak vendit i mungon një përkufizim i qartë se kush do të konsiderohet i ri. As Kushtetuta e Shqipërisë dhe as ligje të tjera nuk përmbajnë ndonjë referencë ligjore në lidhje me këtë çështje. Edhe në Botë nuk ka një konsensus të pranuar se kush do të konsiderohet i ri / e re. Vende të ndryshme përdorin përkufizime të ndryshme, disa të nisura nga normat e OKB-së, ndërkohë që një pjesë e mirë e shteteve Evropiane ndikohen nga standartet e Keshillit të Europës apo të Bashkimit European. Edhe ndërmjet vetë shkencëtarëve nuk ka një mendim të unifikuar në lidhje me këtë çështje.

INSTAT, në raportin e tij të fundit për të rinjtë në Shqipëri konsideron “të rinj” personat ndërmjet moshës 15 dhe 29 vjeç⁶. Të njëjtit dokument dhe grup-moshë i është referuar edhe Plani Kombëtar për Rininë në Shqipëri. Përtej këtyre dokumentave, nuk ka ndonjë vendim zyrtar apo ligj që të garantojë të drejtat e të rinjve në Shqipëri bazuar në një ndarje apo grup-moshë të caktuar.

Organizata e Kombeve të Bashkuara i referohet si të rinj, personave ndërmjet moshës 15 dhe 24 vjeç⁷, bazuar në një sërë dokumentesh të saj, pavarësisht OKB nuk ka ende nje konventë specifike në lidhje me të rinjtë, krahasuar kjo psh me gratë apo fëmijët. Një përkufizim më të gjerë mban Këshilli i Europës dhe Bashkimi European.

Bashkimi European në një sërë dokumentash të tij politikë përcakton si të rinj përgjithësisht personat ndërmjet moshës 15-29 vjeç⁸. Po ashtu Këshilli i Europës, ku Shqipëria është anëtare

³ Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë në Shqipëri 2016-2020, mund të lexohet në këtë lidhje:

http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/plani_kombetar_i_veprimit_per_rinine_shqip.pdf

⁴ Të Rinjtë në Shqipëri, sfidat në kohët që jetojnë”, INSTAT, Tiranë, Nëntor 2015.

⁵ idem

⁶ “Qëllimi i këtij raporti është të paraqesë një vlerësim të jetesës së të rinjve shqiptarë, përfshirë popullsinë e grupmoshës 15 deri në 29 vjeç.” – Raport i INSTAT “Të Rinjtë në Shqipëri, sfidat në kohët që jetojnë”, Tiranë, Nëntor 2015. Botimi mund të lexohet i plotë në këtë lidhje:

http://www.instat.gov.al/media/316719/t_rinjt_n_shqip_ri_sfidat_n_koh_t_q_ndryshojn_.pdf

⁷ Secretary-General’s Report to the General Assembly, A/36/215, 1981 / Secretary-General’s Report to the General Assembly, A/40/256, 1985 / General Assembly Resolution, A/RES/50/81, 1995 / General Assembly Resolutions, A/RES/56/117, 2002 / General Assembly Resolutions, A/RES/62/126, 2008 / Commission for Social Development Resolutions, E/2007/26 & E/CN.5/2007/, 2007. Të dhënat në lidhje me OKB-në dhe përkufizimin për të rinjtë mund të lexohen në lidhjen: <http://www.un.org/esa/socdev/documents/youth/fact-sheets/youth-definition.pdf>

⁸ EU Youth Strategy – Investing and Empowering 2010-2018 / Erasmus + and Youth in Action Programmes / Eurostat reports and Eurobarometer surveys.

që prej vitit 1995⁹, në programet e tij konsideron të rinj përgjithësisht personat ndërmjet moshës 15-29 vjeç. Megjithatë në një sërë dokumentesh të Këshillit bëhet e qartë që përkufizimi “i ri / e re” është një e drejtë që reflektohet dhe rregullohet nga legjislacioni i vendeve anëtare dhe jo normat ndërkombëtare të Këshillit të Europës¹⁰.

Në këtë Raport, ne i jemi referuar si “i ri / e re”, çdo personi që 15- 29 vjeç, bazuar kjo tek përkufizimi i përdorur në Planin Kombëtar të Veprimit për Rininë.

3. Pse një Plan Kombëtar Veprimi për Rininë në Shqipëri?

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të një dokumenti politik të qeverisë paraqet një rëndësi të veçantë, pasi garanton që institucionet e ngarkuara, marrin të gjitha masat dhe vendosin në dispozicion të gjitha burimet, institucionale, rregullatore, humane dhe buxhetore, për të bërë të mundur zbatimin e politikës qeveritare dhe arritjen e ndryshimit të kërkuar. Disa politologë e përkufizojnë atë si: “Veprimet e Qeverisë dhe procesi i politikë-bërjes karakterizohen si një sistem dinamik, kompleks dhe interaktiv, nëpërmjet të cilit identifikohen dhe zgjidhen problemet duke krijuar politika të reja publike ose duke reformuar ato ekzistuese.”¹¹

Në këtë drejtim, Shqipëria ka ndërtuar një imazh publik pozitiv të përgatitjes së politikave kombëtare për të rinjtë, përfshi edhe pjesëmarrjen e tyre në politikë dhe vendim-marrje. Duke nisur nga viti 2005 e në vijim vendi gjithnjë ka miratuar një Strategji Kombëtare për të Rinjtë dhe respektivisht edhe një Plan Kombëtar Veprimi. Është e vështirë të analizosh impaktin që kanë patur Strategjitë Kombëtare për të Rinjtë përgjatë periudhës 2005-2015, pasi asnjëherë nuk ka patur një analizë të detajuar të zbatimit të tyre, buxhetit të dhënë dhe arritjeve ndër vite.

Gjatë vitit 2012 një analizë e shkurtër e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Rininë (2007-2013) tregoi se ndër tre treguesit bazë në lidhje me pjesëmarrjen e të rinjve në politikë dhe në vendim-marrje, të cilat u morën në analizë nga studimi, asnjë prej tyre nuk ishte realizuar¹².

Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë (2015-2020) është një përpjekje ndër-sektoriale për të ndërtuar një politikë të re për mbështetjen e të rinjve në Shqipëri. Ai u përgatit në një proces të gjerë konsultues me të rinj nga i gjithë vendi përgjatë një periudhe 5 mujore. Plani përbën një pjesë substanciale të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020 në Shqipëri¹³.

⁹ Shqipëria u bë anëtare e Këshillit të Europës në 13 Korrik 1995. Per me shume lexo:

<http://www.coe.int/en/web/portal/albania>

¹⁰ “The definition of the age range covered by the terms “young people” or “youth” should reflect the legal and constitutional framework in each member **State.**” - Resolution **CM/Res(2008)23** on the youth policy of the Council of Europe.

¹¹ P. John, *Analysing Public Policy*, (1998) Continuum.

¹² *Rinia Shqiptare: Problemi apo Investimi i Shkëlqyer*, Lëvizja Mjaft & Instituti Axfenda, (2012), Tiranë. (Fq. 8)

¹³ Urdhri nr. 204, datë 25.8.2014, i Kryeministrit, “Për ngritjen e grupit ndërmintor të punës përgjegjës për bashkërendimin, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë, 2014 - 2020

Plani cakton ndër të tjera si qëllim arritjen e gjashtë (6) objektivave strategjike:

1. Nxitja dhe pjesëmarrja e të rinjve në proceset vendim-marrëse demokratike;
2. Nxitja e Punësimit të të Rinjve përmes politikave efektive të tregut të punës;
3. Shëndeti, Sporti dhe Mjedisi;
4. Edukimi i të rinjve;
5. Mbrojtja Sociale;
6. Kultura dhe Vullnetarizmi

Për secilin nga objektivat, Plani i Veprimit cakton nën-objektiva dhe aktivitete të detajuara, të cilat përbëjnë në thelb një plan të plotë pune për strukturat që punojnë për të rinjtë në nivel kombëtar. ***Në total Plani përmban 6 objektiva strategjike, 28 nën-objektiva dhe 105 aktivitete, të ndara sipas fushave të përmendura më sipër.***

Plani ndër të tjera gjithashtu ka përcaktuar edhe indikatorët e matjes së arritjeve të objektivave dhe buxhetin përkatës për realizimin e tyre. Është hera e parë që një Plan Veprimi për të Rinjtë ka caktuar edhe buxhetin përkatës, duke planifikuar burimet e brendshme në dispozicion (në masën 58%) si dhe aktivitetet që buxheti i shtetit i le të pambuluara (në masën 42%) dhe për të cilat Ministria përkatëse do të kërkojë fonde shtesë nga donatorët apo në programe mbështetje të BE-së (si IPA psh) apo shteteve të tjera.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ishte autoriteti përgjegjës për zbatimin e Planit përfshi edhe monitorimin dhe vlerësimin e saj. Me përfundimin e zgjedhjeve të Qershorit 2017 dhe me krijimin më pas të Qeverisë së re, në Shtator të të njëjtit vit, kjo ministri u suprimua dhe strukturat e saj iu bashkangjitën Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.

Plani Kombëtar parashikonte një strukturë të thjeshtëzuar vertikale për të monitoruar dhe vlerësuar zbatimin e tij. Pranë Ministrisë së Mirëqenies do të ngrihej një grup koordinimi të PKVR (me përbërjen e specialistëve nga fushat përkatëse), grup i cili do të monitorojë zbatimin e këtij plani në të gjitha hallkat e tij. Ky grup do të raportojë periodikisht tek Grupi Ndërmintor i ngritur me urdhër të Kryeministrit (dt. 25.8.2014/nr. Prot. 204). Grupi i koordinimit të PKVR do të ketë atributin e organit më të lartë monitorues të planit dhe do të jetë organi vendimmarrës në lidhje me procesin e zbatimit të PKVR-së.

Në këtë aspekt, Raporti i Vlerësimit është një mjet, i cili nxit monitorimin e pavarur nga ana e vetë të rinjve dhe organizatave të tyre të zbatimit dhe impaktit të Planit Kombëtar të Veprimit, duke qenë se vetë të rinjtë janë përfitues, ata kanë interes që ky Plan të zbatohet në kohë dhe sipas parashikimeve.

Për më tepër Raporti i jep një mundësi organizatave rinore që të punojnë së bashku me njëra-tjetrën dhe në partneritet me Qeverinë arritjen e objektivave dhe realizimit të aktiviteteve të saj. Nga ky bashkëpunim është e mundur të punohet dhe të ndikohet tek sa më shumë të rinj e të reja (si përfitues apo edhe zbatues), organizatat e tyre, duke fuqizuar kështu edhe elementin e pjesëmarrjes së të rinjve në vendim-marrjen lokale dhe kombëtare¹⁴.

¹⁴ Shadow Report on Youth Policy, European Youth Forum, Brussels, 2015.

4. Metodologjia

Përgatitja e Raporteve të Monitorim-Vlerësimit nga OSH-të është një proces i gjerë konsultues dhe me pjesëmarrje. Në të marrin pjesë OSHC, që përgjithësisht kanë eksperiencë në mbledhjen e mendimeve të të rinjve, që kanë aktivitet dhe bashkëpunim me institucionet publike dhe që kanë aftësinë të krijojnë dhe formulojnë një opinion për një çështje që i shqetëson të rinjtë.

Raporti nuk përjashton në asnjë moment pjesëmarrjen dhe konsultimin e individëve në të, por ai kërkon të ngrihet mbi argumenta legjitimë që shqetësojnë një grup të gjerë të rinjsh. Tendeca është që këto konsultime të jenë të bazuar në mbledhjen e fakteve reale, të shkeljeve të të drejtave të të rinjve, apo që vijnë nga ndërveprimi midis organizatave dhe institucioneve qeveritare.

Metodologjia e përgatitjes së Raportit të Vlerësimit u ngrit dhe u bazua te plotësimi i një Pyetësores, duke u mbështetur te vëzhgimi nga vetë të rinjtë i realizimit të objektivave strategjike, nëpërmjet përgjigjes së pyetjeve të ndërtuara për këtë qëllim në instrumentin e monitorimit dhe vlerësimit të Planit. Njohja e literaturës në fushë dhe mbledhja e të dhënave dytësore zyrtare nga disa burime, si INSTAT, Ministrinë e Linjës dhe Eurostat, ishin gjithashtu pjesë e metodologjisë.

Po ashtu u organizuan fokus grupe me të rinjtë, komunikim zyrtar me Ministrinë dhe institucionet përgjegjëse të zbatimit të Planit apo mbledhjes së fakteve për të dokumentuar sesi Plani apo institucionet përgjegjëse kanë vepruar për zbatimin e tij. Procesi u ndërtua i tillë që të ishte sa më pjesëmarrës dhe konsultues, dokumentues dhe vlerësues. Në përfundim të procesit të monitorim-vlerësimit, më shumë se 15 organizata joqeveritare u bënë pjesë e tij dhe mbi 300 të rinj e të reja nga e gjithë Shqipëria ndanë mendimet e tyre në lidhje me zbatimin e PKVR-së.

Qëllimi i Raportit nuk është që thjesht të evidentojë, nëpërmjet monitorimit, se sa është zbatuar Plani i Veprimit, por ai kërkon të shërbejë ndër të tjera si një instrument për të adresuar problemet që kanë të rinjtë dhe se ku duhet të fokusohet Qeveria shqiptare për të përmirësuar politikën dhe ndërhyrjet e saj për të rinjtë.

4.1 Instrumenti

Për përgatitjen e Raportit, organizatat vendosën që të përdorin një instrument të ndërtuar mbi pyetje analitike që i jepnin mundësi çdo organizate të analizonte dhe të dokumentonte në fokus grupe me të rinjtë dhe komunikim me institucionet përgjegjëse, se cilat masa ishin zbatuar nga Plani, si janë matur dhe arritur objektivat e tij dhe cilat janë prioritetet për të ardhmen. Në fund të këtij Raporti është bashkangjitur edhe Raporti i plotë i Monitorimit, së bashku me përgjigjet që kanë dhënë organizatat dhe të rinjtë e përfshirë në të.

Instrumenti merr në konsideratë si indikatorët e vendosur për matjen e zbatimit të Planit, sipas vitit përkatës, përfshirë edhe aspektet buxhetore, pra sa është realizuar buxheti i planifikuar dhe, nëse nuk është realizuar, cilët kanë qenë dhe janë faktorët që kanë penguar realizimin.

Periudha e monitorimit dhe vlerësimit të Planit të Veprimit për të Rinjtë, përfshiu 2 vite (2015-2017) dhe analiza përfshiu masat dhe veprimet që ishin planifikuar të realizoheshin në këtë periudhë 3-vjeçare.

Ndërkohë pjesë e instrumentit u bë edhe indeksi i zbatimit të objektivave të Planit të Veprimit (6 objektiva). Në krah të çdo pyetje vlerësuese u vendos edhe një sistem pikëzimi nga 1-10, ku numri 1 tregon mos-zbatim të plotë të objektivit ose aktivitetit të parashikuar, ndërkohë që 10 tregon zbatim të plotë të tyre. Sistemi i pikëzimit është ndërtuar si një mjet që lehtëson vlerësimin e zbatimit të Planit sipas mendimit dhe gjykimit të vetë të rinjve.

Nga ana tjetër, organizatave partnere dhe pjesëmarrëse në përgatitjen e Raportit të Vlerësimit, për aspekte ose pyetje specifike të lidhura me zbatimin, iu rekomandua dërgimi i letër-kërkesave për informacion pranë institucioneve përgjegjëse për të kërkuar informacion me shkrim. Kjo teknikë u përdor sidomos në fusha ku kishte mungesë të informacionit publik dhe ku kërkohej që të evidentoheshin të dhëna të rëndësishme, si buxheti, ndërhyrjet ligjore etj.

4.2 Procesi, hapat dhe organizatat që u bënë pjesë e Raportit të Vlerësimit për të Rinjtë

Procesi i përgatitjes së Raportit të Vlerësimit u udhëhoq nga Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë, në bashkëpunim me CRCA Shqipëri. Një ftesë me e-mail për të bashkëpunuar me të gjitha organizatat e të rinjve dhe forumet politike rinore, u nda masivisht. Ftesa iu dërgua jo vetëm anëtarëve të ANYN, por edhe OSHC-ve partnere të CRCA Shqipëri.

Në total 15 organizata u bënë pjesë e procesit e Raportit dhe kontribuan gjerësisht në përgatitjen e tij përgjatë të gjithë procesit. Gjithashtu dy Forume Politike rinore dhanë mendimet e tyre mbi aspekte specifike të Raportit, të lidhura me pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e të rinjve në politikë. Ndërkohë hapat që u ndoqën për realizimin e Raportit, ishin si më poshtë:

- Identifikimi i organizatave partnere (Tetor - Nëntor 2016)
- Ndarja e listës paraprake të pyetjeve organizatave rinore (Nëntor 2016)
- Organizimi i Fokus Grupeve dhe i Trajnimit të të Rinjve (Dhjetor 2016);
- Shpërndarja dhe plotësimi i pyetësorit, sipas pyetjeve dhe çështjeve. Kërkesa për informacion i drejtohet institucioneve (Janar – Mars 2017).
- Mbledhja dhe analizimi i pyetësorëve / Shkrimi i versionit të parë të raportit (Prill 2017)
- Ndarja e Draftit të parë të Raportit me organizatat pjesëmarrëse (Maj 2017 – për shkak të zgjedhjeve të shtyra në Tetor 2017)
- Rishikimi i Raportit dhe përfshirja në të e të dhënave për vitin (Janar – Mars 2018)
- Konsultimi i Raportit dhe Indeksit në version final (Qershor 2018)
- Finalizimi i Raportit, Indeksit dhe bërja publike e gjetjeve të tij në një prezantim publik (12 Gusht 2018, Dita Ndërkombëtare e Rinisë).

4.3 Trajnimi i organizatave rinore dhe fokus grupet me të rinjtë dhe të rejat

Në vijim të përgatitjes së Raportit dy kurse trajnimi u organizuan nga ANYN dhe CRCA për të rinjtë dhe të rejat pjesëmarrës në proces. Ndërkohë një *retreat* dy ditor u organizua nga ANYN në Durrës gjatë muajit Dhjetor 2016, me organizatat anëtare të saj, për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe aspekteve më të rëndësishme të vlerësimit të zbatimit të Planit Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri. Pjesë e konsultimit u ftuan të bëhen jo vetëm OJF-të, por edhe forumet politike rinore, pasi shpesh roli i tyre në nxitjen e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në vendim-marrje neglizhohet.

4.4 Kufizimet e Raportit

Ky është Raporti i Parë që përgatitet nga të rinjtë për të vlerësuar Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për të Rinjtë të Qeverisë shqiptare. Duke qenë se të rinjtë qëndrojnë ndërmjet grupit të fëmijëve dhe të të rriturve, eksperiencat të përfaqësuara si këto janë të pakta. Në nivel ndërkombëtar Raportet e vlerësimit me pjesëmarrjen e vërtetë grupeve të interesit po gjejnë një përdorim gjithnjë e më të gjerë në monitorimin e zbatimit të politikave të vendeve për të rinjtë, sidomos në nivel Europian.

Disa faktorë pozitivë që lehtësuan procesin ishin: eksperiencat e gjerë të CRCA Shqipëri në përgatitjen e Raporteve Alternative (për fëmijët, gratë, torturën, diskriminimin dhe UPR); trajnimet që iu vunë në dispozicion të rinjve për të kuptuar procesin e monitorimit dhe hapat që shpesh në përgatitjen e një Raporti, vlerësimi serioz, si dhe ekspertiza ndërkombëtare në këtë drejtim (si psh raportet e European Youth Forum).

Megjithatë si çdo raport është e pamundur që edhe ai të mos ketë kufizimet e tij. Ndër kufizimet më kryesore që ne mund të identifikojmë, janë:

- Mungesa e eksperiencës së mëparshme të shumë organizatave rinore në drejtim të njohjes së procesit të raportimit, metodave dhe mjeteve që përdoren gjatë procesit për mbledhjen e të dhënave dhe fakteve, pengoi një pjesë jo të vogël të OSHC-ve rinore që të bëhen pjesë e tij. Megjithatë, kjo si mangësi, u trajtua nga ana e ANYN duke përdorur eksperiencën e gjerë të disa prej anëtarëve të saj dhe mjeteve që ata zotërojnë për të përgatitur raporte të tilla;
- Mungesa e të dhënave, indikatorëve dhe raporteve zyrtare të detajuara për të rinjtë në Shqipëri – e bëri verifikimin e disa prej perceptimeve dhe qëndrimeve të organizatave përkundrejt zbatimit të Planit të vështirë për t'u realizuar. Në këtë drejtim redaktorët e Raportit u munduan të studiojnë dhe të kenë qasje në sa më shumë raporte të mundshme qeveritare (përfshi edhe ato të INSTAT, Bankës Botërore dhe të OKB-së) për të rinjtë në Shqipëri;

- Thuajse asnjë nga 61 Bashkitë e reja të krijuara në Shqipëri, nuk ka një politikë të saj, plane pune, sektor apo buxhet të dedikuar për të rinjtë. Plani Kombëtar në të gjithë elementet e tij, nuk mund të zbatohet, nëse nuk kthehet në një plan pune për çdo bashki në Shqipëri. Në këtë drejtim, raporti e kishte të pamundur që të analizonte punën e bashkive për të rinjtë, pasi kishte mungesë të theksuar informacioni, të dhënash, apo raporte nga ana e tyre, që të mund të lehtësonin edhe përgatitjen e tij. Në këtë aspekt të dhënat dhe vlerësimi i dhënë nga organizatat për punën e bashkive në qarqet dhe bashkitë ku ato punojnë, u morr i mirëqenë.
- Raporti e pati të pamundur për të analizuar buxhetin e shtetit dhe shpenzimet buxhetore për të rinjtë në Shqipëri, pasi Qeveria Shqiptare nuk ka një program buxhetor të saj për të rinjtë dhe mbështetja e saj, përfshi edhe zbatimin e Planit të Veprimit, vjen nga një sërë programesh buxhetore, të cilat nuk janë specifike për Rininë. Kjo e bëri të pamundur analizën buxhetore të Planit të Veprimit, gjë që është një ndër mangësitë e vetë Planit dhe që është edhe një gjetje e Raportit.


5. TË RINJ TË HARRUAR? Të dhëna për të Rinjtë në Shqipëri

Shqipëria nuk është treguar shumë miqësore me të rinjtë dhe të rejtat e saj. Të dhënat statistikore të mbledhura nga burime zyrtare në Shqipëri, nga Bashkimi Europian dhe nga raportet e organizatave ndërkombëtare, tregojnë se fenomenet negative që kanë shoqëruar zhvillimin e vendit, si varfëria, papunësia, mungesa e mundësive etj kanë ndikuar në një masë të madhe në largimin e të rinjve dhe të rejave nga Shqipëria¹⁵.

Më poshtë po paraqesim disa nga faktorët më kryesorë që kanë shoqëruar zhvillimin e të rinjve në Shqipëri. Të dhënat e mbledhura dhe të paraqitura korrespondojnë përgjithësisht me periudhën kohore që përkon me zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për të Rinjtë (2015-2017). Në disa raste këto të dhëna i përkasin censurit të fundit të realizuar në Shqipëri (2011) apo edhe viteve 2013-14, kur është realizuar studimi i fundit zyrtar për të rinjtë në Shqipëri.

5.1 Popullsia e të rinjve në Shqipëri¹⁶

Një sërë raportesh të institucioneve kombëtare dhe të organizatave ndërkombëtare tregojnë jo pa shqetësim se popullsia në Shqipëri po vjen duke u plakur dhe se vendi rrezikon të kthehet nga shteti me popullsinë më të re në Europë (pas Kosovës) në atë me popullësinë më të vjetër. Ndonëse raportet përmendin një sërë faktorësh si ulja e numrit të lindjeve për familje apo migracioni, ne besojmë se faktorë që nuk duhen neglizhuar janë edhe mungesa e shërbimeve shoqërore në komunitet, apo mundësive të pakta për t'u mirë-arsimuar dhe punësuar në një punë që shpërblen me një pagë dinjitoze.




Siç mund të shohim edhe grafiku nr.1 popullsia e të rinjve dhe të rejave në Shqipëri po ndjek një trajektore gjithnjë e në ulje. Në vitin 2018 në Shqipëri jetonin më pak se 700 mijë të rinj nën moshën 29 vjeç. Po të krahasojmë numrin e përgjithshëm të popullsisë të të rinjve (mosha 15 deri në 29 vjeç) në vitin 2014 me të dhënat e vitit 2018, shohim se ajo është ulur me mbi 35


¹⁵ Të Rinjtë në Shqipëri, sfidat në kohët që jetojnë”, INSTAT, Tiranë, Nëntor 2015.

¹⁶ Popullsia në Shqipëri, INSTAT 2018.

mijë veta, që tregon edhe një herë tendencën e përgjithshme të uljes së lindjeve dhe të plakjes së popullsisë në Shqipëri.




Grafiku 2 paraqet përqindjen që zenë të rinjtë përkundrejt numrit të përgjithshëm të popullsisë në Shqipëri. Të dhënat tregojnë se përgjatë periudhës 2014-2018 nuk ka patur ndonjë ndryshim të theksuar në numrin e popullsisë. Megjithatë nga 25% e popullsisë që ishin të rinj në vitin 2014, në vitin 2018, kjo e dhënë shkoi në 24%, pra një ulje me 1%, që është një ndër treguesit e plakjes së mëtejshme dhe graduale të popullsisë në vend.



Popullsia e përgjithshme e vajzave vijon të ketë një diferencë të theksuar me popullsinë e përgjithshme të djemve, pavarësisht se ajo po vjen duke u ngushtuar. Një ndër faktorët kryesorë të përmendur shpesh për këtë diferencë të ndjeshme është preferenca e prindërve për të patur fëmijë djem krahasuar me vajza, e cila shpie në aborte selektive të fëmijëve para se ata të lindin. Në vitin 2018 diferenca ndërmjet djemve dhe vajzave të reja të moshës 15-29 vjeç është 13,108 djem më shumë. Ndonëse ligji i ndalon abortet selektive në Shqipëri përsëri të dhënat tregojnë se fenomeni vijon të prodhojë pasoja negative duke krijuar paparazi të dukshme në atë që duhet të ishte pariteti natyral i sekseve dhe gjinive.

Grafik 4: Martesat tek të rinjtë (2014-2017)




Martesat vijojnë të jenë prezente në jetën e të rinjve thuajse në shifra të barabarta ndërmjet djemve dhe vajzave. Martesa për një pjesë të të rinjve dhe të rejave ofron një mundësi për të filluar një jetë të pavarur nga familja respektive biologjike dhe largim nga kontrolli prindëror. Karakteristikë e martesave është se djemtë janë në pjesën më të madhe më të mëdhenj në moshë sesa vajzat, të cilat në pjesën më të madhe vijojnë të martohen që në moshë të re, rreth 19-20 vjeç. Të dhënat na tregojnë se ka një ulje të ndjeshme të martesave në vitin 2016. Kjo nuk ka ndodhur për shkak të uljes së numrit të popullsisë të të rinjve, por ajo mund të shpjegohet me mungesën e dëshirës për t'u lidhur në një moshë të re, zhvillimit të karrierës apo edhe mundësive të pakta që ofron shteti për mbështetjen e familjeve të reja.

5.2 Varfëria e të rinjve dhe të rejave në Shqipëri

Shqipëria nuk ka një studim për varfërinë e të rinjve dhe të rejave, ndaj është e vështirë që të bësh një analizë të fakteve dhe të të dhënave aktuale. As INSTAT dhe as Banka Botërore nuk kanë paraqitur ndonjë të dhënë specifike sesi varfëria e përgjithshme e popullsisë ndikon në grupmosha të caktuara, përfshirë edhe atë 15-29 vjeç. Për këtë qëllim ne iu drejtuam të dhënave që kanë të bëjnë me varfërinë e përgjithshme të familjeve në Shqipëri.

Grafik 5: GDP e vërtetë e Shqipërisë krahasuar me mesataren e BE-së



Shqipëria vijon ende të mbetet një ndër vendet më të varfëra në Europë. Thuajse 14 përqind e popullsisë vijon të jetojë në varfëri absolute¹⁷ ndërsa thuajse 47 përqind e popullsisë jeton në varfëri relative¹⁸ (mesatare) krahasuar me 22 përqind që është në vendet e rajonit. Varfëria në

¹⁷ SABER country report: Early childhood development, World Bank Group 2015.

¹⁸ An Update on Poverty and Inequality in Albania: 9 Stylized Facts, Poverty Global Practice, World Bank 2015.


Shqipëri, pas krizës ekonomike të vitit 2008 në Bashkimin European, goditi sidomos fëmijët, të rinjtë dhe pensionistët¹⁹. Pabarazia, ndërmjet atyre që kanë dhe atyre që nuk kanë, sa vjen e thellohet. Rreziku i varfërisë është më i lartë në familjet në të cilat kryefamiljari nuk ka arsim fillor ose nuk e ka përfunduar atë (në 18 përqind të rasteve) ndërsa ai është më i ultë për individët që kanë mbaruar arsimin e lartë (në 2%)²⁰.

Shqipëria në Prill të vitit 2014 mori statusin e vendit kandidat për të qenë anëtar i Bashkimit European. Magjithatë, katër vjet pas marrjes së statusit, vendi nuk ka hapur ende negociatat e anëtarësisë për shkak të korrupsionit dhe krimit të organizuar gjerësisht të përhapur. Në Korrik 2018, Shqipëria shpresoi fort për një përgjigje pozitive në këtë drejtim, por Këshilli i BE-së vendosi që t'i shtyjë negociatat për në Qershor të vitit 2019. Ekziston një diferencë tepër e theksuar ndërmjet GDP-së mesatare të vendeve të BE-së dhe asaj të Shqipërisë, gjë që tregon edhe nivelin e varfërisë në të cilën jetojnë të rinjtë në Shqipëri.

Nëse GDP-ja mesatare e BE-së nga viti 2000 në vitin 2017 u rrit thuhet me 5 mijë Euro për person, në Shqipëri ajo u rrit vetëm me 2 mijë Euro për person, që tregon për nivele tepër të ulëta të zhvillimit ekonomik dhe rritjes së ngadaltë të mirëqënies të të rinjve në Shqipëri²¹. Të dhënat dhe grafiku na tregojnë ndër të tjera edhe sesa e vështirë do të jetë për Shqipërinë për të arritur mesataren e BE-së edhe sikur ajo të bëhet anëtare e saj.

5.3 Arsimi i të rinjve në Shqipëri²²

Arsimi është jo vetëm një e drejtë për të rinjtë, por edhe një mundësi për t'u zhvilluar dhe avancuar në jetë. Ai është një ndër shkaqet kryesore të daljes nga varfëria dhe të rritjes së mirëqënies ndërmjet të rinjve. Familja në Shqipëri në përgjithësi e vlerëson arsimin dhe investon një pjesë të të mirave të saj materiale për arsimimin e fëmijëve, por siç tregojnë të dhënat, shpesh vajzat kanë më pak mundësi për të ndjekur arsimin e mesëm dhe të lartë krahasuar me djemtë.



¹⁹ idem


²⁰ The Learning Generation: Investing in Education for a Changing World, The International Commission on Financing Global Education Opportunity. 2016.

²¹ EUROSTAT, Të dhëna mbi GDP-në në vendet candidate,


http://ec.europa.eu/eurostat/tgm/table.do?tab=table&init=1&plugin=1&pcode=sdg_08_10&language=en

²² Arsimi në Shqipëri, INSTAT 2018.

Të dhënat e paraqitura në Grafikon Nr. 6 tregojnë tendencën e përgjithshme se ulja e numrit të lindjeve ka ndikuar drejtpërdrejt në uljen e numrit të nxënësve që ulen në bankat e shkollave të mesme dhe në auditoret e universiteteve. Kjo ulje e konsiderueshme prej mbi 75 mijë të rinj, nuk mund të shpjgohet vetëm me uljen e lindjeve, por edhe mos ndjekjen e arsimit të mesëm apo atij të lartë nga një pjesë e mirë e të rinjve dhe të rejave. Si arsimiti i mesëm ashtu edhe ai i lartë nuk janë të detyrueshme për t'u ndjekur në Shqipëri.




Një aspekt pozitiv i ndjekjes së arsimit nga të rinjtë dhe të rejat në Shqipëri është ulja e diferencës midis të rinjve që mbarojnë shkollën e mesme dhe vijojnë shkollën e lartë. Nëse në vitin shkollor 2013-14 kjo diferencë ishte mbi 20 mijë të rinj, në vitin shkollor aktual ajo u ul me rreth 9 mijë të rinj e të reja.



Të dhënat e grafikut të mësipërm tregojnë se numri i diplomimeve ndërmjet arsimit të lartë dhe atij të detyrueshëm (klasa e 9-të) janë thajse të njëjtë në shifra ndërkohë që ka një rritje të lehtë të diplomimeve të të rinjve në shkollat e mesme. Diplomimet në arsimin e lartë nuk përfshijnë vetëm të rinjtë, por edhe mosha të tjera më të mëdha sesa 29 vjeç, gjë që mund të shpjgohet se pse ato janë thajse të njëjta me ato të arsimit të detyrueshëm. Ndërkohë që ulja e numrit të diplomimeve në arsimin e detyrueshëm na tregon edhe një herë tendencën e përgjithshme të uljes së popullsisë së të rinjve për shkak të uljes së numrit të lindjeve për familje.

5.4 Papunësia tek të rinjtë dhe të rejtat në Shqipëri²³

Papunësia mbetet një ndër shqetësimet kryesore të të rinjve në Shqipëri. Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) në vitin 2015 ngriti për herë të parë shqetësimin e saj në nivel europian se, Shqipëria zinte vendin e parë në Europë për numrin e të rinjve të papunë, ku mbi 30% e të rinjve nuk kishin mundësi të bëheshin pjesë e tregut të punës^{24,25}. Të njëjtat shifra ose më të larta i raportoi INSTAT për të njëjtat vite, ndonëse që prej vitit 2015 disa gjëra kanë ndryshuar për mirë.



Papunësia e të rinjve ka fytyrë mashkullore dhe ndonëse Shqipëria ka zbatuar prej vitesh disa programe të nxitjes së punësimit dhe formimit profesional, djemtë mbeten në një masë më të madhe se vajzat të paintegruar në tregun e punës. Në vitin 2014 thuajse 36 përqind e të gjithë djemve të rinj të moshës 15-29 vjeç ishin të papunë, krahasuar me 27 përqind të vajzave.

Në mënyrë të pashpjegueshme në vitin 2015 kemi një ndërrim të roleve, ku kemi një rritje me 7% të papunësisë së vajzave dhe një ulje relative për djemtë. Ndonëse nuk dihen shkaqet e vërteta të kësaj diference, mbase mbyllja e një apo disa industrive të lidhura specifikisht me punësimin e vajzave mund të jetë një ndër faktorët. Ndërkohë që përgjatë viteve 2016-17 shohim një ulje progresive të papunësisë për të dyja gjininë, ku përsëri vajzat vijnë të jenë më të integruara në tregun e punës sesa djemtë.

Shkalla e papunësisë tek të rinjtë në Shqipëri (15-29 vjeç)				
Vitet	2014	2015	2016	2017
Total (në %)	32,5	33,2	28,9	25,9

Në tërësi mund të thuhet se papunësia vijon të mbetet një ndër problemet më të mëdha të të rinjve, e cila prodhon varfëri, përjashtim social, emigracion dhe kriminalitet tek të rinjtë në Shqipëri. Sipas të dhënave të INSTAT në vitin 2017, thuajse 26% e të rinjve të aftë për punë ishin të paintegruar në tregun e punës në Shqipëri.

²³ Puna në Shqipëri, INSTAT 2018.

²⁴ Share of youth not in employment, education or training in Europe (NEET) 2014-2015, ILO statistics. Mund te aksesohet ne link: http://www.ilo.org/ilostat/faces/oracle/webcenter/portalapp/pagehierarchy/Page3.jspx?MBI_ID=20

²⁵ Global Employment Trends for Youth 2015: Scaling up investments in decent jobs for youth / International Labour Office – Geneva: ILO, 2015


5.5 Emigracioni tek të rinjtë në Shqipëri²⁶

Emigracioni dhe dëshira në masë e të rinjve dhe të rejave për t'u larguar nga Shqipëria për një jetë më të mirë, përbën një ndër sfidat më të mëdha për shtetin dhe shoqërinë në vend. Pavarësisht se ka një tendencë në ulje të emigrimit të paligjshëm dhe zëvendësimit të tij me migrim të ligjshëm, dëshira e të rinjve për ta braktisur Shqipërinë mbetet në nivele tepër të larta.

Në vitin 2015 INSTAT²⁷ dhe World Vision²⁸ raportuan në të njëjtën kohë se mbi 70 përqind e të rinjve shqiptarë dëshironin të largoheshin nga Shqipëria për një jetë më të mirë në një vend European. Përqindja e dëshirës për t'u larguar ishte më e lartë tek djemtë sesa tek vajzat. Në të njëjtën kohë INSTAT raportoi se nga anketat që kishin bërë, rezultonte se 74 përqind e të rinjve të pyetur kishin deklaruar se ishin larguar në emigracion për shkak të kushteve ekonomike²⁹.

Ndërkohë që një raport i Save the Children, i përgatitur me pjesëmarrjen e mbi 1200 të rinjve dhe të rejave mbi moshën 15 vjeç, tregoi se thujse të gjithë të intervistuarit dëshironin të largoheshin nga Shqipëria. Në këtë raport ndër të tjera shkruhet: "Veç dëshirës, fëmijët ishin të qartë edhe lidhur me faktorët nxitës për të emigruar. Disa prej tyre e konsideronin si një mundësi për të përfituar arsim më cilësor, por shumica prej tyre nxiteshin nga varfëria, papunësia, përjashtimi social, dallimet, korrupsioni..."³⁰

Në të njëjtën kohë të dhënat tregojnë se Shqipëria mbetet vendi i parë në Bashkimin European për azil-kërkuesit. Në vitin 2015 mbi 50 mijë persona nga Shqipëria kërkuan azil në BE, ndërsa në vitin 2017 ato u ulën në 22 mijë kërkues³¹. Sipas INSTAT, thujse gjysma e të gjithë emigrantëve të paligjshëm nga Shqipëria janë të rinj e të reja.



²⁶ Puna në Shqipëri, INSTAT 2018.

²⁷ Të rinjtë në Shqipëri: sfidat në kohët që ndryshojnë. INSTAT, Nëntor 2015


²⁸ Puna jonë me të Rinjtë, World Vision Shqipëri.

²⁹ Të rinjtë në Shqipëri: sfidat në kohët që ndryshojnë. INSTAT, Nëntor 2015.

³⁰ Zëri i të Rinjve 2017, Save the Children Shqipëri.


³¹ EUROSTAT, të dhëna mbi emigracionin në 28 vendet e BE-së. Link: http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Asylum_statistics

Sipas INSTAT “për 84 përqind të migrantëve meshkuj, punësimi është qëllimi kryesor i lëvizjes; kjo përqindje është më e ulët për femrat - 61 përqind. Nga ana tjetër, shkaqet familjare luajnë rol për një nga katër femra kundrejt 8 përqind të meshkujve. Në përgjithësi shkollimi është një arsye relativisht e vogël për migracionin jashtë vendit, edhe pse më e rëndësishme për femrat (11) sesa për meshkujt (vetëm 6 përqind).³²”



Të dhënat për vitin 2017, tregojnë se azil-kërkuesit që e kanë për herë të parë, që vijnë nga Shqipëria, kërkojnë azil kryesisht në një numër më të lartë në Francë, që mban edhe rekordin e kërkesave për këtë vit, e ndjekur nga Greqia dhe më pas Belgjika, Irlanda dhe Islanda (që nuk është vend i BE-së por që llogaritet tek statistikat e emigracionit për shkak të qenies pjesë e levizjes në zonën Schengen).

Këto të dhëna konfirmohen edhe nga të dhënat e INSTAT³³. Sipas grafikut No. 12 thuajse 40




mijë qytetarë nga Shqipëria emigruan në mënyrë të ligjshme dhe të paligjshme drejt një vendi tjetër. INSTAT përlllogarit që thuajse gjysma e të gjithë azil-kërkuesve shqiptarë në vendet e huaja janë të rinj, që do të thotë se thuajse 20 mijë të rinj e të reja u larguan nga Shqipëria për të filluar jetën e tyre në një vend tjetër, pjesa më e madhe e tyre për shkaqe ekonomike dhe shumë më pak për studime jashtë shtetit. Të dhënat tregojnë se numri i azil-kërkuesve nga Shqipëria është disa herë më i lartë se ai i të huajve që kërkojnë azil në vend.

³² Të rinjtë në Shqipëri: sfidat në kohët që ndryshojnë. INSTAT, Nëntor 2015

³³ Migracioni dhe integrimi i migrantëve, 2017, INSTAT.


5.6 Kriminaliteti tek të rinjtë³⁴

Grafik 13: Ndarja e të dënuarve sipas moshës, 2013-2017



Shqipëria paraqet të dhëna tepër shqetësuese përsa i përket kriminalitetit rinor. Sipas të dhënave të Ministrisë së Drejtësisë dhe INSTAT, për katër vitet e fundit, thuajse gjysma e dënimeve penale të formës së prerë janë dhënë ndaj të rinjve. Pjesa tjetër i përket moshave nën 15 dhe mbi 30 vjeç. Kjo e dhënë kërkon një adresim më të mirë nëpërmjet politikave të drejtësisë sociale, të cilat për momentin mungojnë.

Grafik 14: Numri i të dënuarve të rinj, 2013-2017



Nëse shikojmë shifrat e dënimeve kuptojmë se në shifra absolute me përjashtim të vitit 2016, nuk ka ndonjë diferencë të theksuar midis të dënuarve të rinj dhe të tjerëve. Të dhënat për vitin 2017 tregojnë se kemi një rritje të kriminalitetit rinor në vend dhe rrjedhimisht edhe të të dënuarve të rinj. Nga viti 2016 në vitin 2017, numri i dënimeve të të rinjve u rrit me 259 persona, një rritje kjo shqetësuese, për shkak edhe të mungesës së programeve dhe qendrave rehabilituese për të rinjtë që kryejnë vepra penale në Shqipëri.


³⁴ Vjetari Statistikor 2017 i Ministrisë së Drejtësisë / Të dhëna të INSTAT për kriminalitetin dhe dënimet në Shqipëri 2018.

6. Indeksi Kombëtar i zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë (2015-2020)

Pjesë e rëndësishme e matjes të zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për të Rinjtë u bë edhe indeksimi i zbatimit të tij, i bazuar të objektivat dhe nën-objektivat e Planit (6 objektiva madhore). Në instrumentin që iu nda të rinjve, në krah të çdo pyetje vlerësuese u vendos edhe një sistem pikëzimi nga 1-10, ku numri 1 tregon mos-zbatim të plotë të objektivit ose aktivitetit të parashikuar, ndërkohë që 10 tregon zbatim të plotë të tij. Sistemi i pikëzimit u ndërtua si një mjet që lehtëson vlerësimin e zbatimit të Planit sipas mendimit dhe gjyqimit të vetë të rinjve, bazuar në eksperiencën dhe matjen që ata i kanë bërë zbatimit të objektivave dhe aktiviteteve të Planit. Të gjitha organizatave që u bënë pjesë e vlerësimit iu kërkua që të plotësonin së bashku me pyetësorin edhe sistemin e vlerësimit me pikë për punën e Qeverisë dhe të Bashkive për të arritur çdo objektiv specifik të PKV-në e Rinisë. Meqënëse aktivitetet e Planit dhe realizimit të Objektivave shtrihen deri në fund të vitit 2020, organizatave iu kërkua që të vlerësonin vetëm ato nën-objektiva dhe aktivitete që duhet të ishin realizuar dhe jo ato që i përkisnin viteve në vijim (2018-2020).

Në përfundim të vlerësimit me pikë, ekspertët përlllogaritën numrin total të pikëve të dhëna nga organizatat dhe i indeksuan ato në përqindje, ku 100 përqind përfaqëson vlerësimin maksimal të mundshëm në pikë që mund të jepej për punën e Qeverisë dhe Bashkive për arritjen e objektivit, ndërsa në krah të tij u vendos përqindja e vlerësuar nga të rinjtë e organizatave për punën e bërë në të vërtetë. Më poshtë po paraqesim rezultatet e dala nga vlerësimi.


Si e vlerësoni mbështetjen e Qeverisë për forcimin e strukturave dhe i kapaciteteve të organizatave Rinore (Objektivi specifik 1.1)?



Siç shihet edhe nga grafiku, 80 përqind e organizatave rinore mendojnë dhe shprehen se Qeveria dhe bashkitë nuk kanë punuar mjaftueshëm në lidhje me forcimin e strukturave dhe kapaciteteve të organizatave rinore. Ashtu siç e tregon edhe Raporti i detajuar, i paraqitur më poshtë, Qeveria dhe bashkitë nuk kanë ndërmarrë thuajse asnjë masë nga ato të parashikuara në Planin Kombëtar të Veprimit në këtë drejtim, ndaj të rinjtë vlerësojnë në këtë masë punën e tyre. Çfarë përbën shqetësim


është se ky vlerësim u ulët vijon përgjatë të gjithë indeksit të të rinjve, gjë që është edhe tregues i pritshmërive të parealizuara të të rinjve anembanë Shqipërisë.

Si e vlerësoni mbështetjen e Qeverisë për rritjen e përfaqësimit të të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe strukturat e qeverisjes vendore (Objektivi specifik 1.2)?



Objektivi specifik 1.2 flet për mbështetjen dhe masat që duhet të marrë Qeveria Shqiptare, institucionet e saj dhe bashkitë, për rritjen e përfaqësimit të të rinjve në proceset vendimmarrëse në nivel kombëtar dhe vendor. Plani për Rininë kishte premtuar që brenda tre vjeçarit të parë të zbatimit të PKVR-së ministria përgjegjëse do të kishte dalë me një propozim ligjor për sa i përket pjesëmarrjes së të rinjve, duke propozuar që Kodi Zgjedhor të sanksionojë pjesëmarrjen e tyre në Kuvend dhe në Këshilla Bashkiakë nëpërmjet një kuote minimum 10%. Ndonëse kjo është një kërkesë edhe e shumë të rinjve të Forumeve Politike Rinore, përsëri ajo mbetet e parealizuara. Grafiku tregon se 73% e organizatave rinore e vlerësojnë punën e bërë nga Qeveria në këtë drejtim të pamjaftueshme.


Si e vlerësoni mbështetjen e Qeverisë për fuqizimin e të rinjve dhe të organizatave Rinore (Objektivi specifik 1.4)?



Pavarësisht se nuk ka patur ndonjë zhvillim të rëndësishëm gjatë kësaj kohe në drejtim të mbështetjes së organizatave rinore, thuajse gjysma e organizatave që u bënë pjesë e Indeksit, mendojnë se Qeveria ka bërë mjaftueshëm në këtë drejtim.

Si e vlerësoni mbështetjen e Qeverisë për promovimin dhe fuqizimin e programeve të nxitjes së punësimit rinor (Objektivi specifik 2.3)?


Grafik Nr.18: Vlerësimi i të rinjve për punën e Qeverisë dhe bashkive për zbatimin e Objektivit specifik 2.3



Organizatave kanë dhënë një ndër vlerësimet më të ulëta në Indeks përsa i përket punës së bërë nga Qeveria dhe bashkitë për promovimin dhe Fuqizimin e programeve të punësimit rinor. Kjo e dhënë e parë edhe nën këndvështrimin e statistikave zyrtare mbi papunësinë e lartë tek të rinjtë, ku në vitin 2015 ILO e renditi Shqipërinë në vendin e parë në Europë për papunësinë e të rinjve, tregon se të rinjtë janë të pakënaqur nga puna e Qeverisë për nxitjen e punësimit rinor.


Si e vlerësoni mbështetjen e Qeverisë për Kartën Rinore (Objektivi specifik 2.6)?

Grafik Nr.19: Vlerësimi i të rinjve për punën e Qeverisë dhe bashkive për zbatimin e Objektivit specifik 2.6




Thuajse i njëjti vlerësim është dhënë nga organizatat edhe përsa i përket punës Qeverisë për të bërë të mundur pajisjen e të rinjve me Kartën Rinore. Pavarësisht se ky është një premtim i bërë nga Qeveria që prej vitit 2013, ai mbetet përsëri i porealizuar. 79% e organizatave Rinore vlerësojnë se Qeveria nuk ka bërë mjaftueshëm për të zbatuar Objektivin specifik 2.6 dhe për të arritur që të rinjtë kudo në Shqipëri të jenë të pajisur me Kartën Rinore. Vlen të theksohet se, pavarësisht se nuk ishte pjesë e këtij vlerësimi, edhe Karta Studentore që duhet të ishte realizuar sipas detyrimeve që ka caktuar Ligji i Arsimit të Lartë, nuk është zbatuar ende.

Si e vlerësoni punën e Qeverisë për përmirësimin e legjislacionit dhe të politikave për mbrojtjen e shëndetit dhe jetës sociale të të rinjve (Objektivi specifik 3.1)?




Objektivi specifik 3.1 kërkonte që Qeveria të punonte së bashku me organizatat Rinore për përmirësimin e legjislacionit dhe politikave për shëndetin dhe jetën sociale të të rinjve. Ashtu siç e tregon edhe Raporti i detajuar, nuk ka patur asnjë zhvillim në këtë drejtim, ndaj edhe 79 përqind e organizatave të të rinjve e kanë vlerësuar negativisht mungesën e veprimeve për plotësimin e këtij objekti.

Si e vlerësoni mbështetjen e Qeverisë për krijimin e shërbimeve miqësore për të rinjtë (Objektivi specifik 3.4)?




Plani Kombëtar i Veprimit ndër të tjera parashikon një set indikatorësh për matjen e realizimit të objektivit specifik 3.4. Në vlerësimin e të rinjve dhe të rejave, 80% e tyre mendojnë se as Qeveria dhe as Bashkitë nuk kanë bërë mjaftueshëm për të ngritur shërbime miqësore për të rinjtë në Shqipëri. Vetëm 20% e organizatave Rinore mendojnë se është bërë diçka në këtë drejtim.

Si e vlerësoni punën e Qeverisë për krijimin dhe mbështetjen e shërbimeve komunitare për të rinjtë (Objektivi specifik 5.2)?



Në të njëjtën linjë me pyetjen e mësipërme shkon edhe kjo pyetje e indeksit, për objektivin specifik 5.2. Organizatave iu kërkua të vlerësonin në raport masat që ka marrë Qeveria për mbështetjen e shërbimeve komunitare për të rinjtë. Pavarësisht se në nivel kombëtar nuk ka patur ndonjë zhvillim të rëndësishëm në këtë drejtim, thuhet gjysma e organizatave mendojnë se ka patur përkrahje dhe mbështetje në këtë drejtim, sidomos në nivel lokal.

Si e vlerësoni punën e Qeverisë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të Planit të Veprimit për të Rinjtë?



Plani Kombëtar i Veprimit për të Rinjtë e detyron Qeverinë dhe ministrinë përgjegjëse që një herë në 6 muaj të përgatisë një raport monitorimi dhe vlerësimi të zbatimit të PKVR. Deri në momentin e përgatitjes së indeksit dhe të këtij raporti, ministria përgjegjëse nuk kishte bërë asnjë raport publik në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të Planit. Për më tepër një sërë strukturash të parashikuara për t'u ngritur në mbështetje të të rinjve dhe të zbatimit të Planit, edhe sot e kësaj dite nuk janë ngritur. Zgjedhjet e vitit 2017 krijuan një hendek edhe më të madh në këtë drejtim, pasi kalimi i çështjes së të rinjve pranë Ministrisë së Arsimit dhe eliminimi i Drejtorisë së Politikave të Rinisë eliminon edhe të vetmen strukturë që mund të koordinonte zbatimin e Planit. Siç e tregon edhe vetë grafiku, mbi 81 përqind e organizatave vlerësojnë se Qeveria nuk ka bërë thuhet asgjë në këtë drejtim.

7. Gjetjet dhe rekomandimet kryesore të Raportit dhe Indeksit Kombëtar i Vlerësimit

7.1 Gjetjet më kritike

Vetëm 21% e Planit të Veprimit për Rininë ishte zbatuar deri në fund të vitit 2017!

Plani i Veprimit nuk është zbatuar në tërësinë e tij dhe sipas objektivave dhe aktiviteteve të parashikuara për t'u përmbushur gjatë periudhës 2015-2016. Nga 48 aktivitete të parashikuara për t'u realizuar gjatë kësaj periudhe, vetëm 10 prej tyre janë përmbushur.

26% e të rinjve aktualisht janë të papunë në Shqipëri! Papunësia e të rinjve është një ndër shkaqet kryesore të emigracionit të paligjshëm të të rinjve nga Shqipëri në vendet e BE-së!

Papunësia e të rinjve ka natyrë mashkullore. Ndonëse Shqipëria ka zbatuar prej vitesh disa programe të nxitjes së punësimit dhe formimit profesional, djemtë mbeten në një masë më të madhe se vajzat të pintepruar në tregun e punës. Në vitin 2014 thuajse 36 përqind e të gjithë djemve të rinj të moshës 15-29 vjeç ishin të papunë, krahasuar me 27 përqind të vajzave. Ndërkohë që përgjatë viteve 2016-17 shohim një ulje progresive të papunësisë për të dyja gjininë, ku përsëri vajzat vijnë më të integruara në tregun e punës sesa djemtë. Sipas të dhënave të INSTAT në vitin 2017, thuajse 26% e të rinjve të aftë për punë ishin të pintepruar në tregun e punës në Shqipëri. Papunësia prodhon varfëri, përjashtim social, emigracion dhe kriminalitet tek të rinjtë në Shqipëri.

Mbi 70% e të rinjve në Shqipëri dëshirojnë të largohen, për shkak të varfërisë, papunësisë, përjashtimit social dhe korrupsionit!

Emigracioni dhe dëshira në masë e të rinjve dhe të rejave për t'u larguar nga Shqipëria për një jetë më të mirë, përbën një ndër sfidat më të mëdha. Pavarësisht se ka një tendencë në ulje të emigrimit, dëshira e të rinjve për ta braktisur Shqipërinë mbetet në nivele tepër të larta. Në vitin 2015 INSTAT raportoi se mbi 70 përqind e të rinjve dëshironin të largoheshin nga Shqipëria për një jetë më të mirë. Ndërkohë një raport I vitit 2017, i përgatitur me pjesëmarrjen e mbi 1200 të rinjve dhe të rejave mbi moshën 15 vjeç, tregoi se thuajse të gjithë të intervistuarit dëshironin të largoheshin nga Shqipëria.

Të dhënat tregojnë se Shqipëria mbetet vendi i parë nga Ballkani Perëndimor për azil-kërkuesit në Bashkimin Europian. Në vitin 2015 mbi 50 mijë persona nga Shqipëria kërkuan azil në BE, ndërsa në vitin 2017 ato u ulën në 22 mijë kërkesa³⁵. Sipas INSTAT, gjysma e të gjithë emigrantëve nga Shqipëria janë të rinj e të reja.

Thuajse 50% e të dënuarve për krime në Shqipëri i përkasin moshës 15-30 vjeç. Vendi nuk ka asnjë politikë sociale apo të drejtësisë për grup-moshën 21-30 vjeç!

Shqipëria paraqet të dhëna tepër shqetësuese përsa i përket kriminalitetit rinor. Sipas të dhënave të Ministrisë së Drejtësisë, thuajse gjysma e dënimeve penale të formës së prerë janë dhënë ndaj të rinjve. Të dhënat për vitin 2017 tregojnë se kemi një rritje të kriminalitetit rinor në vend dhe rrjedhimisht edhe të të dënuarve të rinj. Nga viti 2016 në vitin 2017, numri i dënimeve të të rinjve u rrit me 259 persona, një rritje kjo shqetësuese, për shkak edhe të mungesës së programeve dhe qendrave rehabilituese për të rinjtë që kryejnë vepra penale në Shqipëri.

Deri në fund të vitit 2017, as Qeveria dhe as Bashkitë nuk ngritën ndonjë strukturë për zbatimin e Planit të Veprimit për Rininë!

Mungesa e strukturave institucionale në nivel qendror dhe lokal nuk bëri të mundur zbatimin e Planit dhe aktiviteteve të parashikuara, si rrjedhojë edhe përmbushjen e Objektivave të vendosur. Ndonëse Plani parashikonte krijimin e një grupi ndër-ministoror për monitorimin e zbatimit të tij, nuk rezultoi që ky grup të jetë ngritur apo të ketë funksionuar ndojëherë. Mospatja e një stafi të plotë me të rinj dhe për të rinjtë (vetëm 2 veta), në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Sporteve dhe Rinisë, kapacitetet tepër të kufizuara të këtij institucioni për të kryer punë për të rinjtë, mungesa e informacionit transparent të roleve dhe përgjegjësisë të tyre, vetëm e shtuan paqartësinë mbi rolet e strukturave dhe funksionet e tyre përkatëse.

Deri në fund të vitit 2017, si Qeveria ashtu edhe Bashkitë nuk shpenzuan asnjë lek për zbatimin e Planit të Veprimit për Rininë!

Mungesa e Programit Buxhetor për të Rinjtë në buxhetin e përgjithshëm të Ministrisë, jo vetëm që ndikoi në një mos-përmbushje të indikatorëve të matjes së zbatimit, por për më tepër, i rriti së tepërmi mundësitë që Plani Kombëtar të mos zbatohet.

Mungesa e një skeme financimi të rregulluar me Ligj për mbështetjen e OSHC-ve të të rinjve dhe forumeve politike, pengoi zbatimin e Planit të Veprimit, pasi organizatat, si agentë të ndryshimit, nuk mund të angazhoheshin në mënyrë efektive për të zbatuar një apo disa elemente të Planit Kombëtar për të Rinjtë. Si rrjedhojë, edhe në ato raste kur OSHC-të rinore janë përpjekur të zbatojnë këtë Plan, ai ka qenë i bazuar në dëshirën e tyre të mirë dhe e mbështetur nga financime të huaja, por jo nga burimet e brendshme të Qeverisë Shqiptare.

³⁵ EUROSTAT, të dhëna mbi emigracionin në 28 vendet e BE-së. Link: http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Asylum_statistics

Deri në fund të vitit 2017, si Qeveria ashtu edhe Bashkitë nuk punuan për mbështetjen dhe fuqizimin e organizatave rinore dhe të rinjve!

Mungesa e strukturave koordinuese në nivel Qendror, mungesa e bashkëpunimit dhe strukturave për të rinjtë në Bashkitë e vendit, solli si pasojë mos-zbatimin e Planit. Me përjashtim të Tiranës, Bashkitë e tjera nuk kanë as zë buxhetor dhe as një strukturë specifike për të Rinjtë në territorin e tyre. Mungesa e bazës ligjore dhe rregullatore që do të bënte të mundur koordinimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit, mos-patja e një Ligji për Rininë në Shqipëri, mungesa e një strukture horizontale dhe vertikale të zbatimit të politikës rinore dhe punës me dhe për të rinjtë e bëri thuajse të pamundur zbatimin e Planit, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel lokal.

Mungesa e organeve këshillimore rinore e vështirësoi edhe më tej bashpunimin OSHC-Qeveri, pasi të rinjtë përtej njohjeve apo dëshirës së mirë për të bashkëpunuar, nuk kishin mundësi reale të këshillonin në mënyrë të vazhdueshme strukturat përkatëse rinore në Ministri, Qeveri dhe Bashki (me ndonjë përjashtim) për masat që ato mund të merrnin për të forcuar punën me të rinjtë dhe zbatimin e Planit.

Qeveria nuk ndërmorri asnjë veprim për të nxitur dhe mbështetur pjesëmarrjen e të rinjve dhe të rejave!

Mungesa e mbështetjes politike, përdorimi i të rinjve dhe të rejave më shumë si sfond sesa një pjesëmarrje efektive e të rinjve në politikë-bërje dhe vendim-marrje, mos-sjellja e të rinjve së bashku në të gjitha nivelet e politikës dhe shoqërisë civile (Kuvend – Qeveri – Pushtet Vendor – OSHC) nuk nxiti si rrjedhojë një pjesëmarrje të gjerë apo një lëvizje kombëtare që mund të ndikonte në sjelljen e përmirësimeve dhe ndryshimeve të rëndësishme në jetën e të rinjve dhe si pasojë një peshë më e madhe e rolit që të rinjtë e të rejat mund dhe duhet të luajnë në të vërtetë në Shqipëri.

Mbështetja dhe bashkëpunimi i përciptë me shoqërinë civile, Forumet Politike dhe grupimet rinore vullnetare, nuk arriti të krijonte procese të qëndrueshme të fuqizimit të shoqërisë civile, krijimit të sinergjive të reja për fuqizimin e të rinjve të angazhuar si në organizata ashtu edhe forume politike rinore, që më pas do të bënte të mundur monitorimin dhe vlerësimin e pavarur të zbatimit të Planit të Veprimit dhe politikës shtetërore për të Rinjtë në Shqipëri.

3 vjet pas miratimit të Planit, asnjë Raport Monitorimi apo Vlerësimi nuk është përgatitur nga Qeveria për zbatimin e PKV-së!

Mungesa e monitorimit dhe vlerësimit 6 muajor dhe vjeçar të Planit, përmbushjes së indikatorëve dhe realizimit të aktiviteteve të parashikuara, mungesa e kërkesë-llogarisë brenda vetë Ministrisë, matjes së performancës së stafit të zyrave respektive, krijuan një vakum të shtrirë në kohë të mos-zbatimit të Planit Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri. Si rezultat, thuajse 3 vjet pas miratimit të Planit, asnjë Raport Monitorimi apo Vlerësimi nuk është përgatitur nga strukturat e ngarkuara me këtë funksion.

7.2 Rekomandimet kryesore

Për Kuvendin e Shqipërisë

1. Kuvendi duhet të shikojë me prioritet miratimin e Rezolutës për të Rinjtë dhe krijimin e Nën-Komisionit Parlamentar për të Rinjtë në Kuvendin e Shqipërisë. Është pozitive dhe duhet vlerësuar organizimi i Seancës Dëgjimore për situatën e të rinjve, por ajo duhet të vijojë me marrjen e masave dhe rritjen e kërkesë-llogarisë ndaj Qeverisë në lidhje me faktin se pse 3 vjet pas miratimit të saj, PKBR-ja mbetet e pazbatuar në tërësinë e saj;
2. Komisioni i posaçëm i Reformës Zgjedhore duhet të marrë në konsideratë detyrimin që PKVR-ja ka caktuar për rritjen e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të të rinjve në të gjitha nivelet e vendimarrjes. Në këtë drejtim sanksionimi në Kodin Zgjedhor dhe ligjin për rininë të kuotës minimum 10% mund të jetë një nxitje pozitive për të rinjtë në vend;

Për Qeverinë dhe Këshillin e Ministrave

1. Papunësia e të rinjve është një ndër shkaqet kryesore të emigracionit të paligjshëm të të rinjve në Shqipëri. Programet e punësimit duhet të adresojnë këtë fenomen, duke nxitur krijimin e nën-programeve të reja si ato për nxitjen e punësimit tek djemtë apo bizneset Rinore;
2. Po në këtë kuadër, Qeveria së bashku me Ministrinë e Drejtësisë dhe atë të Mbrojtjes Sociale, duhet të marrin seriozisht në konsideratë hapjen e programeve për mbështetjen në komunitet të të rinjve, si për fuqizimin e tyre ashtu edhe për ata të rinj që kanë sjellje anti-sociale apo kriminale, për t'i krijuar mundësi për t'u rehabilituar dhe riintegruar në shoqëri.
3. Ashtu siç është theksuar shpesh në këtë raport, PKVR-ja nuk është zbatuar në tërësinë e saj. Në këtë aspekt, ne i rekomandojmë Qeverisë Shqiptare që të miratojë një zë specifik për Rininë, në buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe ai të zerë rreth 10% të fondeve të të gjithë ministrisë;

Për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Sportit dhe Rinisë

1. Ministria e Rinisë duhet të ndërmarrë masa sa më të shpejta për të ngritur Këshillin Kombëtar për Rininë, me pjesëmarrjen e të gjithë ministrive të linjës, Bashkive dhe organizatave Rinore në vend, bazuar në eksperiencën pozitive të këshillave të tillë si ai për shoqërinë civile apo barazinë gjinore.
2. Është tepër urgjente ngritja e Drejtorisë së Politikave për Rininë, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si njësi zbatuese e Planit Kombëtar të Veprimit në Shqipëri. Kjo drejtori duhet të ketë për detyrë edhe përgatitjen e raporteve periodike të zbatimit të PKVR-së, të fuqizimit të organizatave Rinore, përgatitjes së propozimeve për politika specifike për të rinjtë etj.

3. Miratimi i Ligjit për Rininë është tashmë një kërkesë dhe rekomandim i vjetër i shoqërisë civile. Ndonëse Ministria ka filluar përgatitjet për projekt-ligjin, procesi dhe mënyra e organizimit të tij tregojnë se pjesëmarrja e të rinjve dhe të rejave në të nuk është e garantuar. Ne do të rekomandojmë që jo vetëm grupi i punës që po përgatit dhe do të konsultojë projektin, por edhe i gjithë procesi të jetë i drejtuar nga të rinjtë, me të rinjtë dhe për të rinjtë.

Për Bashkitë në Shqipëri

1. Në çdo Bashki të vendit, të krijohen Seksionet e Rinisë, ndërkohë që Këshillat Bashkiakë duhet të miratojnë një zë specifik buxhetor për të financuar programet dhe nismat rinore të organizatave dhe grupimeve rinore;
2. Në çdo Bashki të vendit duhet të përgatiten dhe miratohen Planet 3-5 vjeçare të Veprimit për të Rinjtë, si një ndër mënyrat që politikave publike vendore të adresojnë mangësitë që Bashkitë kanë në punën dhe shërbimet për të rinjtë. Eksperienca e Bashkisë Tiranë mund të shërbejë si udhërrëfyes në këtë drejtim.

8. Raporti i detajuar i vlerësimit të zbatimit të PKVR 2015-2017

1.	MISIONI I PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR TË RINJTË
Pyetje	Misioni i Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë është përmirësimi i cilësisë së jetës së të rinjve dhe forcimi i statusit të tyre, përmes zhvillimit të më shumë mundësive në edukim, punësim, shëndetësi, kulturë dhe rritjen e pjesëmarrjes së plotë të të rinjve në shoqëri e në vendimmarrje. Mendoni se ky mision është realizuar gjatë viteve 2015-2016?
Përgjigja juaj:	<p>Misioni i Planit Kombëtar të Veprimit për të Rinjtë është arritur pjesërisht, për arsyet si vijim:</p> <p>Vendimmarje:</p> <ol style="list-style-type: none"> Rritja e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së të rinjve në politikë dhe vendimmarrje është tepër e kënaqshme dhe është rritur ndjeshëm, por gjithçka është arritur në mënyrë individuale nga organizatat dhe forumet politike rinore dhe aspak nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nëpërmjet zbatimit të Strategjisë së Rinisë. Të rinjtë në zonat rurale janë shumë pak të përfshirë në vendimmarrje. <p>Punësim:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sipas INSTAT nga mosha 15-29 vjec, papunësia e të rinjve është në nivele 35% (për vitin 2015). Ç'ka do të thotë që është bërë shumë pak nga ana e MMSR për rritjen e numrit të të rinjve të punësuar në Shqipëri. Politika punësimi diskrimnuese dhe jo gjithëpërfshirëse për të rinjtë. <p>Edukim:</p> <ol style="list-style-type: none"> Aktualisht edhe sot mungon një Kartë Rinore nëpërmjet së cilës ofrohen lehtësira të ndryshme në shëndetësi, art, sport, transport, të mira materiale etj etj. Dështimi i Reformës në Arsim. <p>Shëndetësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> Asnjë shërbim shëndetësor miqësor për të rinjtë në të gjithë Shqipërinë. Ka një mungesë informacioni që të le të nënkuptosh se për të rinjtë nuk është menduar, nuk është bërë asnjë gjë përgjatë viteve 2015-2016. <p>Kulturë dhe aktivitete sociale:</p> <ol style="list-style-type: none"> Shumë pak aktivitete rinore sociale, kulturore të organizuara në 61 Bashkitë e vendit nga institucionet përkatëse, në kuadër të zbatimit të

Strategjisë së Rinisë.

2. Ka më tepër teori sesa gjëra konkrete nga MMSR.

Vullnetarizmi:

1. Ka një ndryshim pozitiv për konceptimin e vullnetarizmit. MMSR e ka nxitur së tepërmi frymën e punës vullnetare tek të rinjtë shqiptarë duke krijuar mundësi angazhimi për këta të fundit në shumë prej institucioneve publike vartëse të saj.

Punësimi:

1. Programi i Praktikave Profesionale dhe të Punësimit pranë MMSR, institucioneve vartëse të saj ka qenë një eksperiencë mjaft pozitive dhe e vlefshme për shumë të rinj në Shqipëri.

2. Programi i vetëpunësimit nga MMSR për 40 ide inovative.

3. Dhënia e kontratave të punësimit për 1000 të rinj, por kur ka mbaruar kontrata nuk është rinovuar. Nga shumë prej organizatave dhe të rinjve konsiderohet si dukje dhe reklamim sesa një punë reale.

Edukim:

1. Investimi në Qendrat e Formimit Profesional ka qenë i dukshëm dhe i prekshëm.

Kulturë dhe aktivitete sociale:

1. Kalimi i Teatrit të Komedisë në Teatrin Eksperimental "Kujtim Spahivogli", i cili është bërë i hapur dhe i aksesueshëm për të rinjtë.

2. Qendrat Rinore kanë qenë një mundësi më tepër për promovimin dhe zhvillimin e aktiviteteve rinore kulturore.

Pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje: asnjë iniciativë për përfshirjen e të rinjve, proces buxhetimi etj.

2.	OBJEKTIVI STRATEGJIK 1. NXITJA DHE PJESËMARRJA E TË RINJVE NË PROCESET/VENDIM-MARRJET DEMOKRATIKE
Objektivi specifik 1.1	Forcimi i strukturave dhe i kapaciteteve të organizatave rinore
Aktiviteti 1.1.1	Ngritja e Shërbimit Kombëtar të Rinisë (SHKR), si institucioni përgjegjës për zbatimin e politikave dhe programeve rinore të miratuara nga MMSR-ja. Ngritja e qendrave rinore rajonale (në varësi të SHKR-së), të cilat do të jenë njësi të drejtpërdrejta për organizimin e aktiviteteve dhe të shërbimeve për të rinjtë.
Pyetje	Mendoni se ngritja dhe funksionimi i SHKR-se i ka shërbyer forcimit të kapaciteteve dhe strukturave të organizatës suaj? Nëse PO, ju lutem shpjegoni shkurtimisht me pika sesi e ka ndihmuar ajo organizatën tuaj!
Përgjigja juaj	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shërbimi Kombëtar i Rinisë është ngritur, por mungojnë kapacitetet dhe profesionistët e vërtetë pranë kësaj strukture për të fuqizuar të rinjtë e tjerë dhe për të organizuar aktivitete rinore në fuqizim e tyre në mbarë vendin. 2. SHKR nuk ka eksperiencë, ekspertizën e nevojshme për hartimin dhe zbatimin e politikave rinore, ku për rrjedhojë edhe Strategjia e Rinisë në të shumtën e objektivave nuk është zbatuar. 3. SHKR prej krijimit nuk ka hartuar asnjë politikë konkrete për të rinjtë (trajnim, fonde, hapësira rekreative përveç Qendrave Rinore). 4. Mungesë fondesh për organizimin e aktiviteteve të ndryshme rinore nga MMSR në bashkëpunim me organizatat rinore të shoqërisë civile në të gjithë Shqipërinë. 5. Janë hapur 3 qendra rinore në Korçë, Vlorë, Tiranë, por ende në Veri të Shqipërisë nuk është hapur një Qendër Rinore.
Aktiviteti 1.1.2	Krijimi i Korpusit të Rinisë
Pyetje	Plani Kombëtar parashikonte ngritjen e Korpusit të Rinisë në vitin 2015. A keni dijeni se pse ky Korpus nuk është ngritur? Cilat mendoni se kanë qenë pengesat apo shkaqet që kanë shpënë në mos-ngritjen e tij? Shpjegoni shkurt duke patur parasysh edhe indikatorët e matjes së tij (përgatitja e kuadrit ligjor / pilotimi i aktiviteteve në 3 rajone)
Përgjigja juaj	<ol style="list-style-type: none"> 1. Nuk është ndërmarrë asnjë nisëm konkrete për krijimin e Korpusit të Rinisë. 2. Arsytet e mosnivicimit për krijimin e këtij Korpusi supozohet të jenë: mungesë buxheti (3 milion e 300 mijë lek), kapacitetesh dhe burime njerëzore për ta ngritur këtë korpus. 3. Mungesë Dëshire. 4. Në vitin 2015 është bërë një takim “fantazmë” i planifikuar “sot për sot”,

	në të cilin nuk u ftua asnjë organizatë rinore aktive.
Aktiviteti 1.1.3	Forcimi i pjesëmarrjes aktive të qeverisë së nxënësve (arsimi parauniversitar) dhe këshillave studentorë (universitete) në proceset e vendimmarrjes dhe rritjen e cilësisë së procesit arsimor.
Pyetje	A keni dijeni se cilat janë aktivitetet që Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (MMSR) ka realizuar për zbatimin e këtij aktiviteti dhe për forcimin e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të rinjve në proceset vendim-marrëse?
Përgjigja juaj	<ol style="list-style-type: none"> 1. Nuk ka asnjë rregullore për krijimin e Këshillave Studentore dhe Qeverive të Nxënësve. 2. Nuk ka patur asnjë aktivitet për forcimin e tyre. Nga MAS ka një fond për aktivitete studentore, por ka vite që nuk është përdorur. 3. Ka patur nisma vetëm nga Bashkia për arsimin parauniversitar në qytetin e Tiranës, por këto nisma kanë qenë të ndara dhe jo të lidhura me zbatimin, implementimin e Strategjisë së Rinisë. 4. Janë krijuar Borde Rinore në disa bashki të Shqipërisë, iniciativa këto të ndërmarra si fillim nga organizatat rinore dhe më pas në bashkëpunim me Bashkitë. 5. Ka patur iniciativa personale të Forumeve Politike Rinore si LRI për përfshirjen e nxënësve të sistemit parauniversitar në vendimmarrje dhe politikë. Nisma këto të pavarura nga zbatimi i Strategjisë së Rinisë. 6. Nuk është zhvilluar asnjë aktivitet fuqizues apo trajnim për qeveritë e nxënësve apo këshillat studentorë nga MMSR. Janë mbajtur trajnime të ndryshme nga forumet politike rinore si LRI, FRESSH etj.
Aktiviteti 1.1.4	Mbështetje teknike për grupet dhe organizatat rinore për aftësimin e tyre në hartimin dhe menaxhimin e plan-bizneseve apo projekteve të ndryshme.
Pyetje	A keni dijeni nëse kjo mbështetje teknike i është ofruar organizatave rinore? A ka qenë organizata juaj përfituese e mbështetjes teknike nga ana e Ministrisë apo të bashkë-organizuara me OSHC-të? Nëse PO jepni shpjegime se kur kanë ndodhur këto trajnime.
Përgjigja juaj	<ol style="list-style-type: none"> 1. Nuk ka asnjë informacion që të jetë bërë ndonjë trajnim fuqizues për aftësimin e të rinjve mbi hartimin dhe menaxhimin e plan-bizneseve apo projekteve të tjera të ndryshme. 2. Mbështetje teknike "0" për grupet dhe organizatat rinore mbi aftësimin e tyre në hartimin dhe menaxhimin e plan-bizneseve.
Objektivi specifik 1.2	Rritja e përfaqësimit të të rinjve në proceset vendim-marrëse dhe strukturat e qeverisjes vendore.
Aktiviteti 1.2.1	Takime avokatie me grupimet politike për të nxitur përfaqësimin e të rinjve në nivel 20% në qeverisjen vendore, duke zbatuar parimet e barazisë gjinore dhe të diskriminimit (këshillat e komunës, këshillat bashkiakë dhe në nivel qarku).
Pyetje	A ka qenë forumi juaj politik ose OSHC-ja (vlen për ato që punojnë për fuqizimin e të rinjve në politikë) pjesë / apo të informuar nga ana e MMSR për këto takime avokatie? Nëse po kur dhe si kanë ndodhur këto takime? Kanë qenë takime të hapura apo të mbyllura? Çfarë është arritur në to? A ka realizuar Forumi / OSHC-ja juaj takime të tilla? A janë organizuar ato në bashkëpunim me MMSR? Jepni shpjegimi (Nëse JO,

	lëreni bosh hapësiren ose shtoni komentin tuaj se pse nuk ka ndodhur kjo gjë)
Indikatorët	<ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i grupit avokues me pjesëmarrjen e 7-10 të rinjve nga forumet rinore të partive politike, organizatave rinore dhe OJF-ve; - Studimi mbi politikat e përfaqësimit të të rinjve 18-29 vjeç në pushtetin vendor dhe hartimi i platformës advokuese, rritjes së përfaqësimit të tyre me 20% në strukturat e qeverisjes vendore do të realizohet gjatë vitit 2015; - Forum kombëtar (2-ditor) me pjesëmarrjen e drejtuesve të lartë të forumeve rinore të partive politike, drejtuesve të lartë partiakë, përfaqësues nga pushteti vendor, organizatat rinore, OJF-të, KQZ-së dhe OSBE-së për nxitjen e përfaqësimit të të rinjve në qeverisjen vendore;
Përgjigja juaj	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të gjitha këto takime, forume kombëtare rinore me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në politikë dhe vendimarrje janë bërë nga organizatat rinore dhe forumet politike rinore por aspak nga MMSR apo ministritë e linjës. 2. Studimi i vetëm mbi “Përfaqësimin e të Rinjve në Politikë dhe Vendimarrje në Shqipëri” është bërë pikërisht në 2015 nga vetë organizatat dhe forumet politike rinore, iniciuar nga CRCA Shqipëri dhe Lidershipi i të Rinjve të Tiranës. 3. Sipas analizimit të Strategjisë së Rinisë dhe fondit të alokuar për këtë pikë, mendohet se këto takime mbështetëse, lobuese dhe avokuese për rritjen e përfaqësimit të të rinjve, grave dhe vajzave në politikë e vendimarrje nuk janë bërë për shkak të pamjaftueshmërisë së fondeve.
Aktiviteti 1.2.2	Krijimi i Bordit Rinor Këshillimor në MMSR dhe strukturat e qeverisjes vendore (këshillat bashkiakë dhe komunë) si një strukturë këshilluese nga të rinjtë në të gjitha fazat e vendim-marrjes, hartimit dhe monitorimit të politikave rinore.
Pyetje	A keni dijeni nëse Bordi Rinor Këshillimor në MMRS është ngritur? Nëse PO, si funksionon ai? Nëse JO, pse? A keni dijeni nëse falë mbështetjes së MMRS janë ngritur Borde Rinore Këshillimore në Bashki? Nëse JO, pse mendoni se ka ndodhur kjo gjë? A keni asistuar ju vetë në ngritjen e Bordeve të tilla dhe nëse PO në cilat bashki? Kush ju ka mbështetur në krijimin e këtyre Bordeve?
Indikatorët	<ul style="list-style-type: none"> - Krijimi Bordit Rinor Këshillimor në MMSR (2015); - Krijimi i Bordit Rinor Këshillimor në strukturat e qeverisjes vendore (2016).
Përgjigja juaj	<ul style="list-style-type: none"> - Nuk ekziston asnjë Bord Rinor nga MMSR në MMSR. Ka Borde Rinore në Bashki, por nuk janë ngritur dhe nuk janë mbështetur në asnjë moment nga MMSR. - Pavarësisht ekzistencës së Bordeve Rinore pranë bashkive të vendit nuk e ndryshojnë situatën, sepse nuk kanë bërë asgjë konkrete për të rinjtë, janë thjesht që të bëjnë lajme Kryetarët e Bashkive.
Aktiviteti 1.2.3	Aktivitete sensibilizuese me qëllim zvogëlimin e stereotipave/diskriminimit gjinor dhe përfshirjen e vajzave të reja në proceset vendimmarrëse dhe jetën publike.

Pyetje	A është zhvilluar ndonjë aktivitet ndërgjegjësues gjatë viteve 2015-2016 në fokus të të cilit ka qenë eliminimi i stereotipeve / diskriminimit gjinor dhe përfshirja e vajzave në politikë? Nëse PO, kush e ka organizuar atë? A ka patur MMRS ndonjë rol në këtë drejtim? Shpjegoni! (Nëse JO, jepni shpjegime pse mendoni se nuk ka ndodhur ky aktivitet?)
Indikatorët	Nje aktivitet sensibilizues rajonal çdo vit
Përgjigja juaj	<p>1. Ka patur aktivitete të shumta ndërgjegjësuese për diskriminimin dhe dhunën me bazë gjinore nga ana e MMSR, por nuk është se ka patur impakt apo te ketë ndryshuar diçka në lidhje me këtë fenomen. Theksohet: ka patur një numër të lartë aktiviteteve ndërgjegjësuese nga ana e MMSR-së në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile. (Trajnimi Gloë, spote publicitare)</p> <p>2. Përsa i përket rritjes së përfaqësimit të grave, vajzave, si dhe të të rinjve në politikë nuk ka patur asnjë nismë/politikë konkrete nga ana e MMSR-së.</p> <p>3. Të gjitha nismat që janë ndërmarrë në kuadër të rritjes së përfaqësimit të grave dhe vajzave, të rinjve në politikë dhe vendimmarje kanë qenë të inicuar nga organizatat rinore të shoqërisë civile, forumet politike rinore, dhe partitë politike ku MMSR nuk ka dhënë asnjë mbështetje për avancimin e tyre. Këtu mund të përmendet Kontrata Sociale e cila solli një impakt të madh në rritjen e përfaqësimit të të rinjve në politikë në Këshillin Bashkiak të Tiranës; mund të përmendet nisma 50%- burra 50% gra në Këshilla Bashkiakë të inicuar nga Koalicioni për Nxitjen e Grave dhe të Rinjve në Politikë. Vendosija e kuotës gjinore 30% në Parlament në zgjedhjet e vitit 2013.</p>
Objektivi specifik 1.3	Ndërgjegjësimi dhe edukimi i të rinjve për pjesëmarrjen në procesin zgjedhor
Aktiviteti 1.3.1	Fushata sensibilizuese me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve dhe organizatave rinore për të qenë pjesë aktive e jetës politike dhe procesit zgjedhor, si dhe nxitja e të rinjve “votues për herë të parë” për të qenë pjesë aktive në procesin zgjedhor.
Pyetje	A ka qenë forumi juaj politik ose OSHC-ja (vlen për ato që punojnë për fuqizimin e të rinjve në politikë) pjesë / apo të informuar nga ana e MMSR për këto fushata? Nëse po kur dhe si kanë ndodhur këto fushata? Çfarë është arritur nga ato? A ka realizuar Forumi / OSHC-ja juaj fushata të tilla? A janë organizuar ato në bashkëpunim me MMRS? Jepni shpjegim (Nëse JO, lëreni bosh hapësirën ose shtoni komentin tuaj se pse nuk ka ndodhur kjo gjë)
Indikatorët	- Organizimi i fushatave kombëtare ndërgjegjësuese në TV dhe rrjetet sociale online për votuesit për herë të parë dhe pjesëmarrjen në zgjedhje
Përgjigja juaj	<p>1. Fushatat sensibilizuese janë ndërmarrë nga forumet politike rinore me anë të takimeve të ndryshme dhe të njëpasnjëshme në shkollat e mesme dhe universitetet në të gjithë vendin.</p> <p>2. Gjithahшту në dobi të sensibilizimit janë bërë edhe spote te ndryshme publicitare në kohë fushate nga LSI.</p>

	3. Mos përmbushja e kësaj pike dhe zhvillimi i aktiviteteve të planifikuara ka ardhur si rrjedhojë e buxhetit "0".
Aktiviteti 1.3.2	Trajnime me të rinjtë dhe grupet/organizatat rinore për forcimin e kapaciteteve të tyre drejtuese, sipas modelit "Future Leaders Initiative".
Pyetje	A ka qeëe OSHC-ja pjesë / apo të informuar nga ana e MMSR për këto trajnime? Nëse po kur dhe si kanë ndodhur trajnimet? Çfarë është arritur nga ato? A ka realizuar OSHC-ja juaj trajnime të tilla? A janë organizuar ato në bashkëpunim me MMRS? Jepni shpjegimi (Nëse JO, lëreni bosh hapësirën ose shtoni komentin tuaj se pse nuk ka ndodhur kjo gjë)
Indikatorët	- 50 të rinj për çdo vit do të trajnohen për tematikat e leadership-it dhe për një vit do të jenë nën kujdesin (mentoring) e një profesionisti të fushës.
Përgjigja juaj	1. Nuk ka asnjë informacion përsa i përket kësaj pjese, ku nga ana e MMSR-së të jenë zhvilluar trajnime të ndryshme për forimimin dhe fuqizimin e 50 liderave rinorë. 2. Janë zhvilluar trajnime të ndryshme fuqizuese për organizata rinore, forume politike rinore dhe aktivistë rinorë, trajnime këto të organizuara nga vetë organizatat rinore të shoqërisë civile. 3. Mosrealizimi i këtyre trajnimeve nga ana e MMSR-së, ndoshta ka ardhur si rezultat i pamjaftueshmërisë së fondit të alokuar për këtë pikë.
Objektivi specifik 1.4	Fuqizimi i mbështetjes për të rinjtë dhe organizatat rinore
Aktiviteti 1.4.1	Bashkëpunimi me Agjencinë Shqiptare për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) për të krijuar një fond specifik për mbështetjen e aktiviteteve të organizatave apo grupimeve rinore.
Pyetje	A keni dijeni nëse ky fond specifik është ngritur pranë AMSHC? Nëse PO, a ka përfituar organizata apo grupi juaj nga ky fond? Nëse JO, cilat mendoni se janë shkaqet që nuk është krijuar ky fond?
Përgjigja juaj	1. AMSHC nuk ka marrë asnjë fond nga MMSR, buxheti disponues nga AMSHC për të mbështetur organizatat rinore të shoqërisë civile është shumë i vogël dhe i pamjaftueshëm. 2. Edhe me këtë fond të vogël, AMSHC nuk është transparente për mënyrën e shpërndarjes së saj tek organizatat aplikuese dhe fituese. 3. Deri më tani nuk është krijuar asnjë fond specifik për mbështetjen e aktiviteteve të organizatave apo grupimeve rinore.
Aktiviteti 1.4.2	Mbështetja e të rinjve që kthehen nga emigracioni dhe sjellin inovacion, praktika të mira pune dhe krijojnë mundësi punësimi nëpërmjet financimit të projekteve të suksesshme të hartuara prej tyre.
Pyetje	A keni dijeni nëse MMRS ka financuar projekte të të rinjve të kthyer nga emigracioni? Nëse PO, ju lutem jepni shpjegime? Nëse JO, pse mendoni se nuk është zbatuar ky aktivitet? A është përfshirë në buxhetin e shtetit fondi i përmendur tek indikatorin më poshtë dhe si është shpërndarë ai (nëse ka ndodhur)?

Indikatorët	- Krijimi i fondit mbështetës për të rinjtë, duke filluar nga viti 2016, me një fond prej 10000000 lekësh dhe me një rritje progresive 10% në vite.
Përgjigja juaj	1. Shërbimi Kombëtar i Rinisë, MMSR, në bashkëpunim me Kryeministrinë prej disa vitesh janë duke zbatuar nismën “Ëndrra Ime”, prej së cilës janë mbështetur një numër i konsiderueshëm idesh inovative rinore. 2. Nëpërmjet “Ëndrra Ime”, në vitin 2016 u mbështetën dhe 3 projekte të hartuara nga 3 të rinj emigrant të cilët janë rrikthyer në Shqipëri. 3. Përsa i përket alokimit të një buxheti prej 100 milion lekësh, nuk kemi asnjë informacion nëse është alokuar dhe nëse PO, si është përdorur.
Aktiviteti 1.4.3	Krijimi i një serveri të veçantë pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për ofrimin e shërbimeve Cloud për organizatat rinore, të cilat nuk kanë mundësi të blejnë pajisjet TIK.
Pyetje	A keni dijeni nëse MMRS e ka krijuar këtë server dhe shërbim për të rinjtë? Nëse PO, na tregoni më shumë sesi dhe ku ofrohet ky shërbim! Nëse JO, pse mendoni se nuk është zbatuar ky aktivitet? A është përfshirë në buxhetin e shtetit fondi i përmendur tek indikatori me poshtë dhe si është shpërndarë ai (nëse ka ndodhur)?
Indikatorët	- Krijimi i serverit në vitin 2016. Buxheti: - Buxheti i shtetit: 1000 000 lek gjatë vitit 2016;
Përgjigja juaj	1. Rinia.al është një portal për të cilin u fol së tepërmi si një sukses i rradhës i MMSR-së në mbështetje dhe informim të të rinjve, por aktualisht që flasim ky portal i krijuar përpara dy vitesh nuk funksionon më. Nëse hyn tek Rinia.al, gjithkush do të lexojë error! 2. Ekziston një portal gjithëpërfshirës (jo vetë për të rinjtë) i titulluar e-albania por nuk ka shërbyer në asnjë moment për të rinjtë në mbarë vendin. 3. Nuk e dimë se si është përdorur fondi i alokuar prej 1000 000 lekë përgjatë vitit 2016 në lidhje me këtë pikë.
Aktiviteti 1.4.8	Fuqizimi i kapaciteteve të medias për pasqyrimin e çështjeve të lidhura me rininë.
Pyetje	A keni dijeni nëse MMRS ka fuqizuar kapacitetet e Medias për të pasqyruar çështjet e lidhura me të rinjtë? Nëse PO, cilat kanë qenë aktivitetet që kanë ndodhur gjatë viteve 2015-16? Nëse JO, cilat mendoni se janë shkaqet që kanë shpënë në mos-zbatimin e këtij aktiviteti? A ka zbatuar OSHC-ja juaj aktivitete fuqizuese për median (takime / trajnime / seminare etj?) Jepni shpjegime.
Indikatorët	- Takime avokuese me grupet mediatike dhe përfaqësuesit e medias; - Bashkëpunim me organet e medias për përgatitjen e tematikave dhe të strukturës së diskutimeve për çështje të ndryshme të lidhura me rininë.
Përgjigja juaj	1. Nuk ka patur asnjë takim fuqizues nga ana e MMSR-së për median në lidhje me pasqyrimin e çështjeve të të rinjve. 2. MMSR duhet që të forcojë së pari kapacitetet e veta për të folur në media (përfaqësuesit rinor në të) dhe më pas të forcojtë kapacitetet e t. ë tjerëve. 3. MMSR në të gjitha rastet e dala në media, ka dalë thjesht për të promovuar punën e vet dhe aspak për të lehtësuar aksesin e të rinjve dhe

organizatave rinore për daljet mediatike.

4. Të rinjtë, organizatat rinore dhe forumet politike rinore në të gjitha rastet kanë përdorur njohjet e veta për të dalë, për t'u promovuar në media. MMSR në asnjë moment nuk ka qenë ndihmuese në lidhje me këtë pikë.

3	OBJEKTIVI STRATEGJIK 2. NXITJA E PUNËSIMIT TË TË RINJVE PËRMES POLITIKAVE EFEKTIVE TË TREGUT TË PUNËS
Objektivi specifik 2.1	Përmirësimi i kuadrit ligjor për nxitjen e programeve të sipërmarrjes rinore
Aktiviteti 2.1.1	Hartimi i indikatorëve nxitës (incentiva) për bizneset të cilat mbështetin apo zhvillojnë programe të nxitjes së punësimit të të rinjve, bazuar dhe në konsultimin me grupet e interesit.
Pyetje	A keni informacion nëse këto incentiva për nxitjen e biznesit për punësimin e të rinjve janë realizuar? Nëse po cila është lista e incentivave të propozuar apo miratuar? Nëse JO, pse mendoni se nuk është realizuar ky aktivitet?
Indikatorët	- Hartimi i indikatorëve nxitës bazuar dhe në konsultimet me grupet e interesit (2015 - 2016)
Përgjigja juaj	1. Bazuar në Programet e Nxitjes së Punësimit, MMSR ka ofruar prej vitit 2014 lehtësi për nxitjen e punësimit të të rinjve tek biznese të ndryshme. 2. Disa prej lehtësirave të ofruara prej Programit të Nxitjes së Punësimit kanë qenë: a) pagesa e 6 rrogave minimale për çdo të ri të punësuar, b) pagesa e sigurimeve shoqërore për 12 muaj për çdo të ri të punësuar. Këto lehtësira janë dhënë nga MMSR dhe SHKP duke ndjekur një formulë që siguronte vijueshmërinë e punësimit të të rinjve përgjatë gjithë vitit.
Aktiviteti 2.1.2	Përshtatja e kuadrit ligjor për njohjen dhe pagesat e praktikave të punës dhe nxitjen e internship-it të të rinjve, si në sektorin publik, ashtu dhe në atë privat.
Pyetje	A keni informacion nëse legjislacioni i propozuar është përgatitur dhe /ose miratuar? Nëse PO, kur u miratua ligji dhe cilat janë arritjet e tij? A keni qenë ju pjesë e këtij procesi? Nëse JO, pse mendoni se nuk është realizuar ky aktivitet?
Indikatorët	- Hartimi i kuadrit ligjor (2016)
Përgjigja juaj	1. Nuk ka patur asnjë përshtatje apo përmirësim të kuadrit ligjor për njohjen dhe pagesat e praktikave të punës dhe nxitjen e intership-it të të rinjve, si në sektorin publik ashtu dhe në atë privat. 2. Nga informacioni që disponojmë: praktikat e të rinjve nuk paguhen nga asnjë institucion publik. 3. Një fakt pozitiv që rezulton vitet e fundit është rritja e nxitjes së intershipeve nga ana e MMSR-së. 4. Programet e praktikave profesionale të ndërmarra nga MMSR prej vitit 2014, i ka ndihmuar së tepërmi të rinjtë për të praktikuar dhe vënë në zbatim njohuritë e marra nga auditoret e universiteteve.
Aktiviteti 2.1.3	Hartimi i kuadrit ligjor për mbështetjen e ideve/programeve inovative përmes skemës së patentimit (copy right).

Pyetje	A keni informacion nëse legjislacioni i propozuar është përgatitur dhe /ose miratuar? Nëse PO, kur u miratua ligji dhe cilat janë arritjet e tij? A keni qenë ju pjesë e këtij procesi? Nëse JO, pse mendoni se nuk është realizuar ky aktivitet?
Indikatorët	- Hartimi i kuadrit ligjor (2016)
Përgjigja juaj	1. Prej vitit 2015, vit në të cilën është vënë në zbatim Strategjia e Rinisë nuk është hartuar asnjë ligj për mbështetjen e ideve/programeve inovative përmes skemës së patentimit (copy right). Të paktën me informacionin e disponuar. 2. Ekziston një kuadër ligjor për mbrojtjen e të drejtës së autorit, i hartuar përpara vënies në zbatim të Strategjisë së Rinisë 2015-2020.
Objektivi specifik 2.2	Rritja e kualifikimit profesional dhe menaxherial të të rinjve
Aktiviteti 2.2.1	Programe trajnuese dhe kurse verore (Summer School) për të rinjtë mbi këshillimin në karrierë, aftësimin profesional, menaxherial, hartimin e planeve të biznesit dhe sigurimin e fondeve.
Pyetje	A keni informacion nëse programet trajnuese dhe kurset verore për këshillimin e karrierës etj kanë ndodhur? Nëse po kur, ku dhe si janë realizuar? Nëse JO, pse mendoni se nuk është realizuar ky aktivitet?
Indikatorët	- Organizimi i dy programeve trajnimi rajonalë/vit me pjesëmarrjen e 50 personave/për takim.
Përgjigja juaj	1. Nuk ka asnjë informacion që të jetë zhvilluar ndonjë summer school, trajnim për të rinjtë për këshillimin e karrierës, aftësimin profesional, menaxherial, hartimin e planeve të biznesit dhe sigurimin e fondeve. 2. Nuk është organizuar asnjë program trajnimi rajonal me pjesëmarrjen e 50 personave për takim. Atëherë kush janë këta 50 të rinj që janë trajnuar dhe në çbazë kriteresh është bërë përzgjedhja e tyre? 3. Summer school, kurset verore në temat specifike në këtë objekt, janë organizuar shpesh herë nga vetë organizatat rinore dhe forumet politike rinore pa asnjë mbështetje nga MMSR.
Aktiviteti 2.2.3	Konsulenca mbi aspektet ligjore, financiare dhe menaxheriale për bizneset fillestare të iniciuara nga të rinjtë.
Pyetje	A keni informacion nëse bizneset e iniciuara nga të rinjtë kanë përfituar nga këto konsulenca? Nëse po kur, ku dhe si janë realizuar? Kush kanë qenë përfituesit? Nëse JO, pse mendoni se nuk është realizuar ky aktivitet?
Indikatorët	- Organizimi i një ëorkshop-i vjetor rajonal me pjesëmarrjen e 25-30 personave; - Krijimi i një grupi ekspertësh, të cilët do të ofrojnë shërbimet e konsulencës për bizneset rinore.
Përgjigja juaj	1. Ekzistojnë StartUp të ndryshme, por këto StartUp nuk janë mbështetur në asnjë moment nga MMSR. 2. MMSR nuk ka ofruar asnjë mbështetje apo konsulencë mbi aspekte ligjore, financiare dhe menaxheriale për boneset fillestare të iniciuara

	<p>nga vetë të rinjtë.</p> <p>3. Nuk është organizuar asnjë ëorkshop vjetor rajonal me pjesëmarrjen e 25-30 personave. Kjo të paktën në bazë të informacionit dhe njoftimeve që janë bërë nga MMSR. Nëse do ishte bërë, do dinim datën dhe se kush janë këta 25-30 personat pjesëmarrës.</p> <p>4. Deri më tani nuk është krijuar asnjë grup ekspertësh për të ofruar shërbime konsulence për bizneset rinore.</p>
Aktiviteti 2.2.5	Organizimi i konkurseve rajonale “Ide krijuese”, me qëllim nxitjen e punësimit të të rinjve, sipërmarrjeve rinore, të shoqëruara me mekanizma nxitës dhe mbështetës. P.sh., ideja inovative më e mirë të zbatohet në bizneset e zonës dhe të drejtohet/menaxhohet nga të rinjtë.
Pyetje	A keni informacion nëse konkuret rajonale të ideve krijuese janë realizuar rregullisht? Nëse po kur, ku dhe si janë realizuar? Kush kanë qenë përfituesit? Nëse JO, pse mendoni se nuk është realizuar ky aktivitet?
Indikatorët	- Organizimi i konkurseve në rajone/çdo vit
Përgjigja juaj	1. Shërbimi Kombëtar i Rinisë, MMSR, në bashkëpunim me Kryeministrinë prej disa vitesh janë duke zbatuar nismën “Ëndrra Ime” (të përvitshme), prej së cilës janë mbështetur një numër i konsiderueshëm idesh inovative rinore.
Aktiviteti 2.2.8	Rritja e mobilitetit të të rinjve për të zhvilluar eksperiencë të shkëmbimit akademik, praktikave profesionale dhe punësime të përkohshme në vendet e Bashkimit Evropian, nëpërmjet aplikimit në programet ERASMUS+ apo programeve të ngjashme.
Pyetje	A jeni ju ose organizata juaj përfituese e programeve të trajnimit / shkëmbimit të mbështetura nga ERASMUS +? Jepni shpjegime për cilat aktivitete jeni mbështetur. Nëse JO, pse mendoni se nuk jeni përfitues i tyre?
Indikatorët	- Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit mes qeverive dhe universiteteve të vendeve të BE-së; - Sesione informuese me të rinjtë mbi mundësitë e studimeve jashtë vendit, të financuara nga programe të ndryshme.
Përgjigja juaj	1. Universiteti i Tiranës (duke përfshirë të gjitha fakultetet) kanë marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbime akademike, trajnime etj. 2. Universitetet aplikojnë vetë për Erasmus +, por deri më sot MMSR nuk ka aplikuar dhe zbatuar asnjë projekt të Erasmus +. 3. Janë zhvilluar disa sesione informuese mbi Erasmus + nga Organizata “Përtej Barrierave” në bashkëpunim me MMSR-në. 4. Ministria e Integritetit ka zhvilluar një seri seancash informuese mbi programet e Erasmus +.
Objektivi specifik 2.3	Promovimi dhe fuqizimi i programeve të nxitjes së punësimit rinor
Aktiviteti 2.3.1	Krijimi i inkubatorëve (si në terma të hapësirës fizike, ashtu edhe në ata të zhvillimit të shërbimeve për mbështetjen e biznesit) me detyrën për të ofruar një mjedis të favorshëm, për të favorizuar suksesin e mundshëm në shfaqjen e iniciativave inovative të biznesit.

Pyetje	A keni informacion nëse inkubatorët e biznesit rinor janë krijuar? Nëse PO, ku? A janë ato funksionale? Sa të rinj janë përfitues të tyre? Sa nga bizneset rinore të mbështetura nga inkubatorët vijojnë ende të funksionojnë?
Indikatorët	- Financimi i sipërmarrjes rinore/aktiviteteve prodhuese për 100 të rinj.
Përgjigja juaj	1. Nuk ka asnjë Inkubator Bisnesi! 2. Inkubatori i Biznesit ekzistues nuk funksionon, por shfrytëzohet nga disa biznese private. (ekziston ende ngërçi pronësi dhe vartësi mes MMSR-së dhe Bashkisë Tiranë). 3. Nuk ka asnjë informacion mbi lehtësira të ndryshme fiskale për bizneset e ndryshme rinore. 4. Nuk ka asnjë informacion në lidhje me aktivitete prodhuese për 100 të rinj.
Aktiviteti 2.3.2	Nxitje e punësimit ndërmjet programeve të punësimit.
Pyetje	Sa ka qenë buxheti i shtetit për punësimin e të rinjve gjatë vitit 2015 dhe 2016? Sa është numri i përfituesve të rinj/të reja nga programet e nxitjes së punësimit? Si dhe sa ka ndryshuar % e papunësisë të të rinjve nga viti 2015 në vitin 2016? A shënon ajo ulje, rritje apo asnjë ndryshim?
Indikatorët	- Formim nëpërmjet punës, mbështetje financiare për punëkërkuarët e papunë nr. trajnuar/të punësuar. Rritja e mbulesës së tyre me 30% në vit.
Përgjigja juaj	1. Buxheti i Shtetit për nxitjen e punësimit të të rinjve për vitin 2013 ka qenë 800 mijë dollar, në vitin 2014 ka qenë 1.7 milion dollar ndërsa në vitin 2015 ka qenë 4.7 milion dollar. Përsa i përket vitit 2016 nuk ka ndonjë të dhënë se sa ka qenë ky buxhet. 2. Pavarësisht rritjes së Buxhetit të Nxitjes së Punësimit, nuk ka transparencë se si dhe kujt i është shpërndarë ky fond. 3. Flitet shumë nga MMSR dhe nga Kryeministri për rritjen e numrit të të rinjve të punësuar, por të rinjtë e konsiderojnë papunësinë si problemin më të madh në vend. Një shifër e saktë se sa ka qenë numri i të rinjve të punësuar në vitin 2015 dhe 2016 nuk jepet.
Aktiviteti 2.3.4	Mbështetja e aktiviteteve (artizanale, bimë medicinale, pemëtari, kopshtari) që nxisin vetëpunësimin e vajzave/grave të reja nga zonat rurale.
Pyetje	Cilat kanë qenë nismat që ka zbatuar MMRS (nëse keni dijeni) në lidhje me këtë aktivitet? A është organizata juaj zbatuese e ndonjë nisme / projekti pjesë e këtij aktiviteti në bashkëpunim me MMRS? Jepni shpjegime. Nëse JO, pse mendoni se nuk është realizuar? Komenti juaj.
Indikatorët	- Mbështetja dhe pilotimi i programeve në zonat rurale (2016); - Mbështetja dhe zgjerimi i programeve të vetëpunësimit në zonat rurale.

Përgjigja juaj	<p>1. Me informacionin që disponojmë, nga ana e MMSR-së nuk ka asnjë program pilot në zonat rurale për të mbështetur aktivitetet artizanale, bimë medicinale, pemtari, kopshtari që nxisin vetëpunësimin e vajzave/grave të reja.</p> <p>2. Me informacionin që disponojmë, Bashkia e Tiranës në vitin 2016 alokoi një buxhet prej 60 milion lekë të vjetra për nxitjen e vetëpunëimit dhe sipërmarrjeve të grave dhe vajzave në Tiranë. <i>(por kjo nuk ka të bëjë fare me zbatimin e Strategjisë së Rinisë)</i></p> <p>3. Ambasada Gjermane prej disa vitesh ka financuar projekte të ndryshme dhe nisma nxitëse për vetëpunësimin e grave dhe vajzave në qytetet në veri të Shqipërisë.</p>
Aktiviteti 2.3.4	Ofrimi i mjediseve për zhvillimin e bizneseve rinore, me çmime simbolike/të subvencionuara apo duke përdorur asetet shtetërore që nuk janë në përdorim aktual.
Pyetje	Cilat kanë qenë nismat që ka zbatuar MMRS (nëse keni dijeni) në lidhje me këtë aktivitet? A është organizata juaj zbatuese e ndonjë nisme / projekti pjesë e këtij aktiviteti në bashkëpunim me MMRS? Jepni shpjegime. Nëse JO, pse mendoni se nuk është realizuar ky aktivitet? Komenti juaj.
Indikatorët	- Publikimi i listës me mjedise të lira që mund të përdoren për bizneset rinore.
Përgjigja juaj	<p>1. Asnjë institucion vartës i MMSR-së, ministrive të linjës nuk ka dhënë deri më sot një lehtësim, subvencionim apo mbështetje për zhvillimin e bizneseve rinore, me çmime simbolike apo duke përdorur asetet e tyre.</p> <p>2. Nuk është vënë asnjë listë në dispozicion, në të cilën të pasqyrohen mjediset e lira (nëse ka) që mund të përdoren për bizneset rinore.</p> <p>3. Përgjatë viteve 2015-2016 nuk është bërë asgjë mbi këtë pikë, asgjë në lidhje me hapjen e Inkubatorit të Biznesit.</p>
Objektivi specifik 2.4	Fuqizimi i burimeve të informacionit mbi punësimin
Aktiviteti 2.3.1	Fuqizimi i portalit Rinia.al dhe portaleve të tjera me informacione periodike e të përditësuara mbi legjislacionin e punësimin, të procedurave mbi hapjen dhe sistemet e taksimit të biznesit, tregut të punës, skemave mbështetëse për sipërmarrjet rinore e të tjera.
Pyetje	A e keni vizituar këtë portal ndonjëherë? Nëse PO, a ofron ai informacionin që përmendet këtu? Cilat janë mangësitë e këtij portali? Komenti juaj.
Indikatorët	- Portali Rinia.al dhe portalet e tjera, përditësuar me informacionet përkatëse.
Përgjigja juaj	<p>1. Rinia.al është një portal për të cilin u fol së tepërmi si një sukses i rradhës i MMSR-së në mbështetje dhe informim të të rinjve, por aktualisht që flasim ky portal i krijuar përpara dy vitesh nuk funksionon më. Nëse hyn tek Rinia.al, do të lexoni error!</p> <p>2. Ekziston një portal gjithëpërfshirës (jo vetë për të rinjtë) i titulluar e-albania por nuk ka shërbyer në asnjë moment për të rinjtë në mbarë</p>

	vendin. 3. Nuk e dimë se si është përdorur fondi i alokuar prej 1000 000 ekë përgjatë vitit 2016 në lidhje me këtë pikë.
Objektivi specifik 2.6	Karta Rinore
Aktiviteti 2.3.1	Përgatitja e Kartës Rinore dhe ekuivalentimi me Kartën Evropiane për Rininë
Pyetje	A keni dijeni nëse Karta Rinore është miratuar dhe funksionon? Jepni shpjegime! Nëse JO, pse mendoni se nuk është realizuar ky aktivitet që do të sillte një sërë shërbimesh shtesë dhe mbështetje për të rinjtë kudo në Shqipëri? Komenti juaj.
Indikatorët	- Hartimi i Kartës Rinore
Përgjigja juaj	Nuk është bërë asgjë mbi krijimin e Kartës së Rinisë.

4	OBJEKTIVI STRATEGJIK: SHËNDETI, SPORTI DHE MJEDISI
Objektivi specifik 3.1	Përmirësimi i legjislacionit dhe i politikave për mbrojtjen e shëndetit dhe i jetës sociale të të rinjve
Aktiviteti 3.1.2	Hartimi i akteve ligjore që ndalojnë reklamat e pijeve alkoolike apo lojërave të fatit në mjediset përreth institucioneve arsimore.
Pyetje	A keni dijeni apo keni marrë pjesë në takime / konsultime për hartimin e këtyre akteve ligjore? A keni dijeni nëse ka filluar diskutimi për përgatitjen e tyre apo është ngritur grupi i punës për përgatitjen e tyre? Komenti juaj.
Indikatorët	- Aktet ligjore të hartuara dhe të vendosura në zbatim (2016-2017)
Përgjigja juaj	<ol style="list-style-type: none"> 1. Duke iu referuar punës sonë të përditshme në organizata dhe hulumtimeve në media, internet, rezulton se nuk ka patur asnjë konsultim për hartimin e akteve ligjore që ndalojnë reklamat e pijeve alkoolike apo lojërave të fatit në mjediset përreth institucioneve arsimore. 2. Nuk ka patur asnjë takim konsultues mbi hartimin e këtyre akteve nënligjore. 3. Nuk është ndërmarrë, por pritët që të ndërmerret nga një parti politike siç është LSI (akti nënligjor për pijet alkoolike apo lojërave të fatit në mjediset përreth institucioneve arsimore).
Objektivi specifik 3.2	Forcimi i edukimit shëndetësor në zinxhirin e sistemit arsimor Aktiviteti. Rishikimi i moduleve mbi shëndetin në lëndët biologji dhe aftësim për jetën dhe vendosja e lëndës së edukatës seksuale në arsimin parauniversitar.
Aktiviteti 3.2.1	Forcimi i shërbimit social-shëndetësor në sistemin parauniversitar
Pyetje	Sipas jush a është realizuar ky aktivitet? Cilat kanë qenë masat dhe aktivitetet që janë ndërmarrë nga ana e Ministrive për ta realizuar atë? A ka zbatuar organizata juaj ndonjë aktivitet në këtë kuadër? Nëse JO, cili është komenti juaj në lidhje me mos-realizimin e aktivitetit?
Indikatorët	<ul style="list-style-type: none"> - Trajnime periodike të punonjësve social-shëndetësorë; - Ulja e numrit të nxënësve në ngarkim për çdo punonjës social dhe psikolog shkollor.
Përgjigja juaj	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sipas konstatimeve, na rezulton se kurrikula është krijuar prej 2 vitesh. 2. Janë trajnuar 150 mësues mbi tematika të ndyrshme me karakter social dhe shëndetësor. 3. Pritët që MAS të miratojë futjen e edukatës seksuale në sistemin parauniversitar. 4. Roli i psikologut dhe punonjësve social në shkolla vijon të jetë ende inekzistent për shkak të numrit të madh të nxënësve, shkollave dhe kopshteve që një psikolog apo punonjës social mbulon.

Objektivi specifik 3.3	Ndërgjegjësimi dhe edukimi i të rinjve për sjelljet e shëndetshme
Aktiviteti 3.3.1	Zbatimi i programeve të veçanta informuese, edukuese për parandalimin e IST-së dhe HIV/AIDS-it te të rinjtë përmes një bashkëpunimi të koordinuar dhe efektiv të strukturave shëndetësore, edukuese dhe shoqërisë civile.
Pyetje	Sipas jush a është realizuar ky aktivitet, duke marrë parasysh edhe indikatorët? Cilat kanë qenë masat dhe aktivitetet që janë ndërmarrë nga ana e Ministrive për ta realizuar atë? A ka zbatuar organizata juaj ndonjë aktivitet në këtë kuadër? Nëse JO, cili është komenti juaj në lidhje me mos-realizimin e aktivitetit?
Indikatorët	- Aktivitete informuese për komunikimin dhe ndryshimin e sjelljes (COMBI); - Sesione informuese dhe edukuese për IST/HIV/AIDS-in dhe shëndetin seksual në shkolla dhe jashtë saj; - Fuqizimi i mekanizmave të pjesëmarrjes së të rinjve në fushata dhe aktivitete sensibilizuese.
Përgjigja juaj	1. Në bazë të informacionit që disponojmë, ka patur një seri programesh, nisma dhe fushata ndërgjegjësuere, edukuese, sensibilizuese për parandalimin e HIV/AIDS, IST, të ndërmarrë nga disa prej ministritë e linjës si Ministria e Shëndetësisë, Arsimit dhe Mirëqënies 2. Organizatat e shoqërisë civile kanë bërë një punë mjaft të mirë duke zhvilluar trajnime të ndryshme në shkolla mbi tematika si HIV/AIDS, ISST, SST, për një sjellje sa më të shëndetshme nga ana e të rinjve. 3. Ka patur aktivitete informuese për komunikimin dhe ndryshimin e sjelljes (COMBI).
Objektivi specifik 3.4	Shërbime miqësore për të rinjtë
Aktiviteti 3.4.1	Rihapja e qendrave miqësore për të rinjtë, sipas modelit Youth Friendly Services, shërbim i pilotuar vite më parë në mënyrë të suksesshme nga UNICEF-i, të cilat do të ofrojnë informacione, këshillime, aktivitete parandaluese dhe referime lidhur me parandalimin e sjelljeve me rrezik te të rinjtë.
Pyetje	Duke marrë për bazë indikatorët, a keni dijeni nëse ndonjë qendër e modeluar si miqësore për të rinjtë, të jetë hapur në qarkun tuaj? A ka zbatuar organizata juaj ndonjë aktivitet në këtë kuadër? Nëse JO, cili është komenti juaj në lidhje me mos-realizimin e aktivitetit?
Indikatorët	- Ngritja e të paktën një qendre “Shërbime miqësore për të rinjtë” në çdo prefekturë.
Përgjigja juaj	1. Në kuadër të zbatimit të Strategjisë së Rinisë, nuk është ngritur/hapur asnjë qendër për të ofruar shërbime miqësore për të rinjtë. 2. Ka Qendra të cilat ofrojnë shërbime miqësore për të rinjtë si ARSIS, SHKEJ, por këto nuk janë ngritur apo të funksionojnë në kuadër të zbatimit të Strategjisë së Rinisë.
Aktiviteti 3.4.3	Fuqizimi i qendrave rajonale të planifikimit familjar (PF) dhe testimi dhe i qendrave të këshillimit vullnetar (QTKV) për HIV/AIDS-in me qëllim nxitjen e të rinjve të marrin shërbimet social-shëndetësore të ofruara nga këto qendra.

Pyetje	Duke marrë për bazë indikatorët, a keni dijeni nëse qendrat rajonale të planifikimit familjar të jenë fuqizuar në qarkun tuaj? A ka një qendër të tillë në qarkun tuaj? A funksionon ajo? A ka zbatuar organizata juaj ndonjë aktivitet në këtë kuadër? Nëse JO, cili është komenti juaj në lidhje me mos-realizimin e aktivitetit?
Indikatorët	- Aktivitete ndërgjegjësuese në shkolla me organizatat rinore dhe të rinjtë në komunitet, nëpërmjet shpërndarjes së broshurave; - Rritja e numrit të të rinjve që marrin shërbimet në këto qendra.
Përgjigja juaj	1. Në lidhje me këtë pikë mund të thuhet se rol kryesor dhe dominues në organizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese në shkolla kanë qenë organizatat e shoqërisë civile. Nuk duhet që Ministritë e linjës të mjaftohen thjesht me lehtësimin procedural për të hyrë në shkolla dhe për të zhvilluar këto trajnime dhe sesione informuese. 2. Ministritë duhet të jenë vetë iniciueset e këtyre trajnimeve. 3. Nuk kemi një informacion të saktë së sa është frekuentimi i të rinjve në këto qendra sepse nuk e dimë a ekzistojnë?! 4. Nuk kemi informacion nëse është bërë diçka në lidhje me fuqizimin e qendrave rajonale të planifikimit familjar (PF) dhe a është bërë diçka për testimin e qendrave të këshillimit vullnetar (QTKV) për HIV/AIDS-in me qëllim nxitjen e të rinjve për marrjen e shërbimeve social-shëndetësore të ofruara nga këto qendra.
Objektivi specifik 3.7	Aktivitete sensibilizuese në mbrojtje të mjedisit
Aktiviteti 3.7.1	Mbështetje të OJF-ve rinore që punojnë në fushën e mjedisit, përmes bashkëpunimit ndërinstytucional (ministritë e linjës), agjencive të mjedisit dhe donatorëve të ndryshëm.
Pyetje	Duke marrë për bazë indikatorët, a keni dijeni nëse OJF-të rinore që punojnë në fushën e mjedisit kanë përfiturar këtë mbështetje të parashikuar nga Plani? A ka zbatuar organizata juaj ndonjë aktivitet në këtë kuadër? Nëse JO, cili është komenti juaj në lidhje me mos-realizimin e aktivitetit?
Indikatorët	- Organizimi i dy programeve trajnime rajonal në vit me pjesëmarrjen e 50 personave për takim.
Përgjigja juaj	1. Nga informacioni që kemi, OJF-të rinore që punojnë në fushën e mjedisit nuk janë mbështetur në asnjë moment nga ministritë e linjës dhe agjenci të mjedisit. 2. Nuk është organizuar ndonjë program trajnime rajonal përgjatë dy viteve zbatuese të Strategjisë së Rinisë. Si rrjedhojë nuk mund të diskutojmë për përfshirjen e 50 personave për takim. 3. Ka shumë organizata që punojnë në fushën e mjedisit, të cilat janë shumë aktive dhe organizojnë një seri aktivitete dhe ne asnjë moment nuk kanë marrë asnjë mbështetje nga asnjë. Këto organizata ose shohin mundësi mbështetje jashtë shtetit ose fusin dorën në xhep për ti sjellë një të mirë komunitetit në të cilin jetojnë.
Aktiviteti 3.7.2	Nxitja e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në hartimin dhe monitorimin e politikave mjedisore në nivel lokal dhe kombëtar.

Pyetje	A është ftuar organizata juaj të marrë pjesë dhe të japë kontribut / të konsultohet në lidhje me politikat mjedisore në nivel lokal dhe kombëtar? Nëse PO, ju lutem përshkruani se kur dhe si ka ndodhur ky proces. Nëse JO, pse mendoni se nuk është realizuar ky aktivitet? Komenti juaj.
Indikatorët	- Numri i të rinjve pjesëmarrës në hartimin dhe në monitorimin e politikave mjedisore në nivel qendror dhe lokal.
Përgjigja juaj	1. Organizatat më aktive mjedisore në asnjë moment nuk janë ftuar për të diskutuar një politikë mjedisore si në nivel lokal ashtu dhe në atë qendror. Ndoshta se këto takime të planifikuara nuk janë organizuar në asnjë moment përgjatë vitve 2015-2016. 2. Nuk është hapur asnjë proces monitorimi apo hartimi për politika të ndryshme mjedisore dhe për rrjedhojë nuk mund të flasim për një pjesëmarrje dhe përfshirje të organizatave mjedisore.
Aktiviteti 3.7.4	Fushata të vazhdueshme ndërgjegjësimi dhe sensibilizuese, të organizuara nga OJF-të apo grupime rinore, në mbrojtje të mjedisit dhe reduktimit të ndotjes së ajrit.
Pyetje	A është ftuar organizata juaj të marrë pjesë dhe të japë kontribut në organizimin e këtyre fushatave? Nëse PO, ju lutem përshkruani se kur dhe si ka ndodhur ky proces. A keni organizuar ju vetë fushata të tilla dhe nëse PO, a keni patur mbështetjen e MMSR? Nëse JO, pse mendoni se nuk është realizuar ky aktivitet? Komenti juaj.
Indikatorët	- Fushata kombëtare (çdo vit) me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Tokës/të Mbrojtjes së Mjedisit.
Përgjigja juaj	MMSR përfshihet vetëm duke angazhuar vullnetarë, por që të ndërmarrë një nismë apo iniciativë konkrete në mbrojtje dhe zhvillim të mjedisit deri më tani nuk është parë një gjë e tillë. 2. Bashkëpunimi me institucionet dhe organizatat mjedisore ka qenë tepër i vakët, kjo jo për mosdëshirën e organizatave. 3. Ministria e Mjedisit thjesht bashkohet në aktivitete për të bërë një foto dhe për të justifikuar punën konkrete dhe reale që duhet të bëjë. 4. Sipas opinionit të organizatave të mjedisit, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka qenë ministria më e hapur dhe bashkëpunuese në lidhje me zhvillimin dhe mbrojtjen e mjedisit, krahasuar me ministrinë e tjera të linjës.
Aktiviteti 3.7.6	Organizimi i veprimtarive të ndryshme rinore në zonat turistike, me qëllim promovimin dhe mbrojtjen e tyre.
Pyetje	A keni dijeni nëse veprimtari të tilla turistike, me pjesëmarrjen e të rinjve janë organizuar gjatë viteve 2015-2016? Nëse PO ju lutem shpjegoni se ku kanë ndodhur e si janë përfshirë të rinjtë në to? Nëse JO, pse mendoni se ka ndodhur mos-realizimi i këtij aktiviteti? Komenti juaj.
Indikatorët	- Numri aktiviteteve dhe zonat turistike ku organizohen këto aktivitete.

Përgjigja juaj	<p>1. Janë organizuar një seri aktivitesh madhore në zonat turistike për mbrojtjen, pastrimin dhe promovimin e këtyre mjedisve nga një ndër organizatat më të mëdhaja mjedisore, Green Line Albania. GLA ka organizuar: 6 nisma të mëdha pastrimi, dy fushata sensibilizuese (Green Tour 2015, 2016), nisma Të Pastrojmë Bregdetin. Për të gjitha këto, Green Line nuk ka marrë asnjë mbështetje financiare nga MMSR apo nga ndonjë ministri tjetër e linjës.</p> <p>2. MMSR në kuadër të zbatimit të Strategjisë së Rinisë ka bërë shumë pak, për të mos thënë fare aktivitete në zonat turistike në dobi të promovimit, ndërgjegjësimin, pastrimit dhe mbrojtjes së tyre.</p>
Objektivi specifik 3.8	Programe/iniciativa rinore që ndikojnë në uljen e ndotjes mjedisore
Aktiviteti 3.8.1	Mbështetja e iniciativave/bizneseve inovative rinore që reduktojnë ndotjen mjedisore dhe nxisin procesin e riciklimit.
Pyetje	Duke marrë për bazë indikatorin, a keni dijeni nëse organizata rinore ose vetë të rinj janë mbështetur për hapjen e bizneseve të tyre të riciklimit apo për reduktimin e ndotjes mjedisore? Nëse PO, ju lutem shpjegoni se cilat kanë qenë aktivitetet në këtë kuadër. Nëse JO, cili është komenti juaj në lidhje me mos-realizimin e aktivitetit?
Indikatorët	- Numri i bizneseve rinore mjedisore të mbështetura.
Përgjigja juaj	Nuk është krijuar asnjë biznes rinor mjedisor, si dhe nuk ka patur asnjë mbështetje në lidhje me këtë gjë nga ana e MMSR-së, Ministrisë së Mjedisit apo ndonjë Ministri tjetër e linjës.
Aktiviteti 3.8.2	Organizimi Panairit të Ideve të Gjelbërta, ku të rinjtë të shpalosin idetë dhe mendësitë e reja për mbrojtjen e mjedisit dhe mirëmenaxhimin e burimeve mjedisore.
Pyetje	Duke marrë për bazë indikatorin, a keni dijeni nëse ky Panair është realizuar? Nëse PO, ju lutem shpjegoni se cilat kanë qenë aktivitetet në këtë kuadër. Nëse JO, cili është komenti juaj në lidhje me mos-realizimin e aktivitetit?
Indikatorët	- Organizimi i një panairi vjetor kombëtar.
Përgjigja juaj	Rezulton të jetë zhvilluar një Panair i Ideve të Gjelbërta, por për organizatat rinore dhe organizatat të cilat punojnë me fokus mjedisin nuk ka asnjë informacion në lidhje me këtë gjë. Këto të fundit nuk janë njoftuar në asnjë moment kur është zhvilluar si Panair.

5	OBJEKTIVI STRATEGJIK 4. ARSIMI DHE EDUKIMI I TË RINJVE
Objektivi specifik 4.2	Promovimi i ekselencës dhe forcimi i kapaciteteve
Aktiviteti 4.2.3	Zhvillimi i trajnimeve me përfaqësues të universiteteve, të rinjve dhe organizatave rinore mbi mundësitë që ofron ky program për të rinjtë.
Pyetje	A ka marrë pjesë organizata juaj në ndonjë takim kombëtar në lidhje me Erasmus + për organizatat dhe studentët? Nëse PO ju lutem jepni shpjegime se ku dhe kur ka ndodhur ky Takim Kombëtar dhe çfarë u arrit prej tij? A ka organizuar OSHC-ja juaj ndonjë takim të tillë? Nëse JO, komenti juaj se pse nuk është realizuar ky aktivitet?
Indikatorët	- Organizimi i një takimi kombëtar vjetor me pjesëmarrjen e 100-120 personave.
Përgjigja juaj	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përsa i përket një Takimi Kombëtar vjetor, të planifikuar për tu mbajtur në vitin 2015 ose 2016 mbi Erasmus+ me organizatat dhe të rinjtë, nuk është zhvilluar asnjëherë. 2. Ndërkohë ka patur aktivitete të ndryshme informuese mbi Erasmus+ nga MMSR në bashkëpunim me organizatën si pikë kontakti në Shqipëri "Përtej Barrierave". 3. Gjithashtu ka shumë organizata të tjera si "Rinia për Sipërmarrjen e Lirë" në Kukës dhe shumë organizata të tjera të cilat organizojnë trajnime dhe aktivitete informuese mbi Erasmus+. 4. Referuar fuqizimit dhe informimit mbi Erasmus+ mund të përmendet këtu edhe një trajnim mjaft cilësor në vitin 2015 nga Olof Palme Centre në qytetin e Durrësit.

6	OBJEKTIVI STRATEGJIK 5. MBROJTJA SOCIALE
Objektivi specifik 5.1	Parandalimi i dhunës dhe trafikimit të rinjtë
Aktiviteti 5.1.3	Forcimi kapaciteteve të OJF-ve, grupeve rinore dhe komunitetit në përgjithësi mbi parandalimin dhe referimin e hershëm të dhunës dhe trafikimit, si dhe denoncimin e rasteve të dhunës dhe familjes.
Pyetje	A ka marrë pjesë organizata juaj në ndonjë trajnim apo seminar në lidhje me çështjen e mësipërme? Nëse PO ju lutem jepni shpjegime se ku dhe kur kanë ndodhur ato dhe çfarë u arrit prej tyre? A ka organizuar OSHC-ja juaj ndonjë trajnim në këtë fushë? Nëse JO, komenti juaj se pse nuk është realizuar ky aktivitet?
Indikatorët	Organizimi i një takimi kombëtar (një herë në dy vjet) me pjesëmarrjen e 100-120 të rinjve dhe përfaqësues të OJF-ve rinore.
Përgjigja juaj	<p>- 21 Nëntor 2016: ALO 116 në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, organizuan ëorkshopin Kombëtar "Interneti i Sigurtë për Fëmijët në Shqipëri", "Mbrojtja online në kuadër të sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijëve". Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Mirqënies Sociale dhe Rinisë dhe synuan forcimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri.</p> <p>- 12 Dhjetor 2016: ALO 116 prezantoi Platformën Kombëtare për Sigurinë e Fëmijëve në Internet: ëëë.ISigurt.al dhe aplikacionin në celular ISigurt.al</p> <p>- 22 Dhjetor 2016: CRCA Shqipëri në bashkëpunim me ALO 116, Koalicionin për Arsimin e Fëmijëve në Shqipëri, MMSR, Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri, MAS, Avokatin e Popullit dhe në bashkëpunim me shumë organizata të tjera që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve organizuan "Konferencën e 2-të Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna e Fëmijëve në Shqipëri".</p> <p>- MMSR dhe asnjë ministri tjetër e linjës nuk ka organizuar asnjë takim kombëtar (1 herë në dy vjet) me pjesëmarrjen e 100-120 të rinjve dhe përfaqësues të OJF-ve rinore.B282</p>
Objektivi specifik 5.2	Shërbimet komunitare për të rinjtë
Aktiviteti 5.2.2	Ngritja dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së shërbimeve të përkujdesjes sociale që ofrojnë shërbime shoqërore për të rinjtë dhe kategori në nevojë (përdorues droge, viktime trafikimi etj.)
Pyetje	A ofron organizata juaj shërbime të përkujdesit shoqëror për të rinjtë? Nëse po, përshkruani çfarë shërbimesh ofroni? A ju ka mbështetur dhe financuar qeveria qendrore dhe lokale për ofrimin e këtyre shërbimeve? Sa përqind e shërbimit tuaj financohet nga shteti? Ndërkohë a keni të dhëna apo informacion që ky zë në buxhetin e shtetit të jetë rritur me 10% në vitin 2016?

Indikatorët	- Rritja e fondit të përkujdesjes sociale 10% në vit, bazuar në buxhetin e 2015.
Përgjigja juaj	<p>1. Ekzistojnë disa Organizata të cilat në shërbim të punës së tyre kanë hapur Qendra Sociale ditore, ku ofrohen shërbime mjaft të mira dhe cilësore për të rinjtë në Tiranë dhe në të gjithë Shqipërinë. (Theksohet: puna dhe këto qendra të hapura janë të pavarura nga puna që MMSR bën dhe në të shumtën e rasteve janë të financuara nga organizata ndërkombëtare).</p> <p>2. Nga informacioni që disponojmë, nuk rezulton që të ketë patur një rritje 10% të fondit të përkujdesjes sociale në vitin 2015.</p> <p>3. Nga shteti, respektivisht nga Ministritë e linjës përfshi këtu edhe MMSR-në shërbimet shoqërore (miqësore) për të rinjtë në vitet 2015-2016 kanë munguar. (ka patur shumë pak shërbime të ofruara në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile apo ato ndërkombëtare)</p>

7	OBJEKTIVI STRATEGJIK 6. KULTURA DHE VULLNETARIZMI
Objektivi specifik 6.1	Mbështetja e artistëve të rinj dhe grupeve rinore kulturore
Aktiviteti 6.1.1	Krijimi i lehtësirave për të rinjtë dhe organizatat rinore në qasjen ndaj institucioneve kulturore dhe artistike.
Pyetje	A ka përfituar organizata juaj nga ndonjë lehtësi e tillë e parashikuar në Planin Kombëtar? A keni dijeni nëse Ministria ka miratuar një urdhër për përdorimin e Kartës Rinore në të tilla raste? Nese JO, komenti juaj se pse nuk është realizuar ky aktivitet?
Indikatorët	- Krijimi i një urdhri ministror, që lejon të rinjtë e pajisur me Kartën Rinore të kenë qasje të plotë në institucionet kulturore dhe artistike: - Numri i të rinjve që kanë përdorur institucione kulturore dhe artistike.
Përgjigja juaj	1. Aktualisht nuk disponohet një Kartë Rinore dhe jo më të ketë një urdhër ministror për krijimin dhe pajisjen me Kartë Rinore të të rinjve në mbarë vendin! 2. Nuk kemi një të dhënë të saktë se sa të rinj kanë përdorur institucionet kulturore dhe artistike për të frekuentuar ndonjë aktivitet socio-kulturor, por vlen të theksohet se për nxitjen e ndjekjeve të sa më shumë aktiviteteve nuk është ofruar asnjë lehtësim nga ana e Ministrive të linjës. 3. Shumë të rinj dhe organizata rinore kanë përdorur mjediset e institucioneve të ndryshme kulturore si Muzeu Kombëtar, Reja, apo mjediset e Kryeministrit, Parlamentit, Kuvendit, por aksesimi është bërë me njohje personale dhe në asnjë moment me lehtësimin e MMSR-së apo Ministrive të tjera të linjës në kuadër të zbatimit të Strategjisë së Rinisë.
Aktiviteti 6.1.2	Mbështetje për grupet e reja rinore kulturore dhe artistike (këngë, teatro, animacione) dhe popullarizim të tyre në ngjarje apo festa të rëndësishme.
Pyetje	A është mbështetur organizata juaj financiarisht nga Ministria e Mirëqenies për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike? Nëse po ju lutem shpjegoni se për çfarë aktiviteti / nisme? Nëse JO, jepni shpjegime se pse nuk është realizuar ky aktivitet?
Indikatorët	- Mbështetje financiare për projektet e të rinjve.
Përgjigja juaj	1. Grupimet rinore artistike kanë patur një mbështetje nga Ministria e Kulturës por edhe ajo e MMSR-së për të promovuar organizimin e këtyre aktiviteteve kulturore dhe artistike. 2. Ministria e Kulturës, nga informacioni që disponojmë, ka mbështetur dhe çdo vit hap thirrje për aplikim për mbështetjen e aktiviteteve të ndryshme kulturoro-artistike. Këtë mbështetje me grante, Ministria e Kulturës e ka të rregulluar me ligj. Vlen për tu theksuar se kjo ministri është e vetmja, e cila mbështetjen e organizatave të ndryshme me grante e ka të

	<p>rregulluar me ligj.</p> <p>3. Përgjatë viteve 2015-2016, nuk njohim ndonjë eksperience që MMSR të ketë mbështetur ndonjë aktivitet artistiko-kulturor apo edhe social.</p> <p>4. Arsyet se përse nuk janë mbështetur organizatat rinore në lidhje me këtë pikë mendohet se mund të jenë, ose mos alokimi i një fondi të posaçëm ose mungesa e dëshirës dhe fokusit në këtë pikë.</p>
Aktiviteti 6.1.3	Organizimi i festivaleve rinore kombëtare (të tipit “Art gjithëpërfshirës”) dhe ndërkombëtare.
Pyetje	Jepni komentin tuaj nëse ky aktivitet i përvitshëm është realizuar ose jo. Cilat mendoni se janë shkaqet që mund të kenë shpënë në mos-realizimin e tij?
Indikatorët	<ul style="list-style-type: none"> - Mbështetja e kompeticionit “Art gjithëpërfshirës”. - Mbështetja e një festivali rinor ndërkombëtar.
Përgjigja juaj	<p>1. Në djetën tonë dhe nga informacioni që kemi, rezultojnë të mos jetë zhvilluar asnjë kompeticion "Art gjithëpërfshirës", si dhe të jetë mbështetur ndonjë festival ndërkombëtar nga ana e MMSR-së, apo Ministrisë e tjera të linjës.</p> <p>2. Nuk kemi asnjë informacion për zhvillimin e festivaleve të ndryshme ndërkombëtare!</p>
Aktiviteti 6.1.4	Mbështetje e projekteve dhe programeve të përbashkëta rajonale midis organizatave rinore dhe artistike, me qëllim nxitjen e dialogut ndërkulturor, tolerancën reciproke, shkëmbimet rinore dhe njohjen e praktikave më të mira.
Pyetje	A ka përfituar organizata juaj ndonjë mbështetje teknike për të aplikuar për projekte rajonale me organizata të tjera? Nëse po, ku ka konsistuar kjo mbështetje? A keni zbatuar ndonjë projekt të përbashkët me Ministrinë në këtë drejtim? Jepni shpjegime.
Indikatorët	- Mbështetje logjistike dhe teknike (in kind contribution) për projekte të përbashkëta nga organizatat dhe grupet rinore.
Përgjigja juaj	<p>1. Mbështetja e vetme e dhënë nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë për organizatat rinore të shoqërisë civile është thjesht vënia në dispozicion në përdorim e Qendrës Rinore të Tiranës.</p> <p>2. Nuk kemi zbatuar asnjë projekt të përbashkët me MMSR dhe më gjerë, veçse bashkëorganizimi i disa aktiviteteve me ta (edhe këto të fundit të iniciuara nga organizatat rinore të shoqërisë civile apo forumet politike rinore).</p> <p>3. MMSR ka zhvilluar një seri shkëmbimesh rinore të financuara nga donatorë të ndryshëm, por përzgjedhja e pjesëmarrësve në këto shkëmbime le shumë vend për diskutim dhe pikëpyetje!</p>

Objektivi specifik 6.3	Hartimi i ligjit për vullnetarizmin
Aktiviteti 6.3.1	Konsultimi i draftit të vullnetarizmit me grupet rinore dhe grupet e tjera të interesit.
Pyetje	A u konsultua organizata juaj me Ligjin e Vullnetarizimit? Nëse po, jepni shpjegime në lidhje me procesin dhe sesi u zhvillua ai. Nëse JO, ju lutem shpjegoni, sipas mendimit tuaj, pse nuk u përfshi organizata juaj në këtë proces?
Indikatorët	- Një takim konsultues në çdo prefekturë.
Përgjigja juaj	1. Nuk ka patur takime të hapura konsultative me organizatat rinore mbi ligjin e vullnetarizmit (edhe nëse janë bërë, janë bërë në mënyrë informale nga Kejdi Mehmetaj dhe me dëshirën e mirë të disa organizatave, rrjeteve rinore). Rast konkret në mospërfshirje në këto takime konsultuese është Lëvizja Kombëtare: "Ta Pastrojmë Shqipërinë" me mbi 140.000 vullnetarë. 2. Hartimi i ligjit nuk u bë nga MMSR sic ishte menduar, por u bë nga një grup deputetësh duke lënë kështu jashtë procesit edhe vetë Ministrinë dhe të gjithë faktorët dhe aktorët e tjerë si OJF-të dhe AMSHC-në.
Aktiviteti 6.3.2	Përgatitja e infrastrukturës për hartimin e kuadrit legjislativ për ligjin e vullnetarizimit.
Pyetje	Mendoni se Ministria krijoi infrastrukturën e duhur për hartimin e ligjit për vullnetarizmin? A është kuadri i ri ligjor i ngritur mbi praktikën më të mira botërore? A ka mbështetur Ministria krijimin dhe forcimin e një rrjeti të vullnetarëve për të promovuar vullnetarizmin? Jepni shpjegimet tuaja.
Indikatorët	- Kuadri ligjor i hartuar sipas standardeve dhe praktikave më të mira botërore; - Krijimi i një sistemi informacioni për vullnetarizmin përmes kanaleve televizive dhe mediave sociale, si: Facebook, Tëitter, You Tube e të tjera; - Krijimi dhe forcimi i rrjetit vullnetar për të lobuar dhe promovuar rëndësinë e punës vullnetare.
Përgjigja juaj	Në asnjë moment nuk u krijua një: - Kuadër ligjor i hartuar sipas standardeve dhe praktikave më të mira botërore; - Sistem informacioni për vullnetarizmin përmes kanaleve televizive dhe mediave sociale, si: Facebook, Tëitter, You Tube e të tjera; - Krijimi dhe forcimi i rrjetit vullnetar për të lobuar dhe promovuar rëndësinë e punës vullnetare. Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë iu bashkua procesit vetëm në fund të tij, në momentin e miratimit. Për të mos thënë që s'ka qenë fare pjesë e procesit...

Aktiviteti 6.3.3	Krijimi i bonuseve/incentivave apo sistemit të kreditimit për pjesëmarrjen e të rinjve në punë/aktivitete vullnetare.
Pyetje	A ka marrë apo përfituar organizata juaj në ndonjë formë mbështetje institucionale (nga MMSR) dhe financiare për mobilizimin e të rinjve për të dhënë kontribut vullnetar? Jepni shpjegime.
Indikatorët	- Mbështetja institucionale dhe financiare e organizatave që mobilizojnë të rinjtë për të dhënë kontribute vullnetare.
Përgjigja juaj	1. Nuk ekziston asnjë lloj mbështetje institucionale dhe financiare për organizatat që mobilizojnë të rinjtë për të dhënë kontribute vullnetare.
Aktiviteti 6.3.4	Organizimi i aktiviteteve të ndryshme me qëllim promovimin e ndjenjës së vullnetarizmit dhe rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete me bazë vullnetare.
Pyetje	A është ftuar apo ka qenë organizata juaj pjesë e ndonjë sesioni / seminari informimi të organizuar nga MMSR për përfshirjen e të rinjve në Shërbimin Evropian Vullnetar apo në fushatat e informimit dhe sensibilizimit për promovimin e vullnetarizmit? Jepni shpjegime.
Indikatorët	- Numri i aktiviteteve të organizuara (realizimi i 2 seminareve informuese për përfshirjen e të rinjve në Shërbimin Evropian Vullnetar, ku do të marrin pjesë rreth 100 të rinj); - Realizimi i 2 fushatave informuese/sensibilizuese për promovimin e vullnetarizmit.
Përgjigja juaj	1. Nuk ka patur asnjë aktivitet të mirëfilltë nga ana e MMSR-së për të promovuar vullnetarizmin. Përveç aktiviteteve që ministria ka organizuar për prezantimin e fushatës "6 Objektiva për 6 Muaj".

8	MONITORIMI DHE VLERËSIMI
Aktiviteti	Ngritja e Grupit të Monitorimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë (PKVR)
Pyetje	<p>Ndër të tjera, Ministria e Mirëqenies dhe Rinisë kishte parashikuar në Planin Kombëtar të Rinisë edhe ngritjen e një Grupi Monitorimi PKVR.</p> <p>A keni dijeni nëse ky grup është ngritur? A është organizata juaj pjesë e këtij grupi apo ka ndjekur mbledhjet e tij? Jepni shpjegimet dhe përshtypjet tuaja në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin që i është bërë / i duhej bërë Planit.</p>
Përgjigja juaj	<p>1. Përgjatë zbatimit të Strategjisë së Rinisë në vitet 2015-2016 nuk kemi informacion fare për ngritjen e një Grupi Monitorimi të PKVR. Asnjë prej organizatave rinore nuk e njeht këtë grup dhe për rrjedhojë i bie që të mos jetë krijuar deri më sot.</p> <p>2. Nuk e dimë nëse është ngritur, dhe jo më të jemi pjesë e këtij grupi apo të kemi ndjekur mbledhjet e tij.</p>
Aktiviteti	Vlerësimi i PKVR-së (I përvitshëm)
Pyetje	<p>Ndër të tjera Plani Kombëtar i Veprimit për të Rinjtë, parashikon edhe vlerësimin e përvitshëm të zbatimit të Planit.</p> <p>A keni dijeni apo keni marrë pjesë / jeni informuar nëse procesi i vlerësimit është organizuar deri më sot? Nëse PO, a mund të ndani me ne një kopje të raportit të vlerësimit për vitin 2015 dhe për vitin 2016? Nëse JO, pse mendoni se Ministria nuk e ka realizuar këtë aktivitet të rëndësishëm për zbatimin e Planit të Veprimit për të Rinjtë?</p>
Përgjigja juaj	<p>1. Si organizata rinore, me ne nuk është ndarë asnjë Raport Vjetor për vlerësimin e zbatimit të PKVR-së.</p> <p>2. Nuk jemi përfshirë në asnjë proces vlerësimi sepse nuk ka patur një të tillë përgjatë këtyre dy viteve.</p> <p>3. I vetmi proces që po marrim pjesë është pikërisht procesi i hapur nga CRCA Shqipëri në bashkëpunim me Leadershipin dhe Rrjetin Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri.</p>
Aktiviteti	Raportimi për PKVR-në (3 muaj dhe 1 herë në vit - 4 raporte në total cdo vit)
Pyetje	<p>Plani Kombëtar i Veprimit për të Rinjtë, parashikon edhe raportimin në lidhje me zbatimin e Planit, një herë cdo 3 muaj dhe më pas një herë në vit. A keni dijeni apo keni marrë pjesë / jeni informuar nëse procesi i raportimit është organizuar deri më sot? Nëse PO, a mund të ndani me ne një kopje të raporteve periodike për vitet 2015 dhe 2016? Nëse jo, pse mendoni se Ministria nuk e ka realizuar këtë aktivitet të rëndësishëm për zbatimin e Planit të Veprimit për të Rinjtë?</p>

Përgjigjja juaj	<ol style="list-style-type: none">1. Në asnjë moment nuk është raportuar 1 herë në 3 muaj, ashtu sic edhe PKVR parashikon. Nuk kemi patur raportim 1 vjeçar dhe jo më 1 raportim njëherë në 3 muaj.2. Mungesa e dëshirës dhe ekspertizës së nevojshme, por edhe për vetë faktin se skanë çfarë të raportojnë kur nuk është zbatuar asgjë nga PKVR.
------------------------	---

Referenca

- VKM 204, i datës 25.08.2014, “Për ngritjen e grupit ndërmintor të punës përgjegjës për bashkërendimin, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë, 2014 – 2020.
- Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë në Shqipëri 2016-2020, mund të lexohet në këtë lidhje: http://ëëë.sociale.gov.al/files/documents_files/plani_kombetar_i_veprimit_per_rinine_shqip.pdf
- “Të Rinjtë në Shqipëri, sfidat në kohët që jetojnë”, INSTAT, Tiranë, Nëntor 2015.
- Secretary-General’s Report to the General Assembly, A/36/215, 1981 / Secretary-General’s Report to the General Assembly, A/40/256, 1985 / General Assembly Resolution, A/RES/50/81, 1995 / General Assembly Resolutions, A/RES/56/117, 2002 / General Assembly Resolutions, A/RES/62/126, 2008 / Commission for Social Development Resolutions, E/2007/26 & E/CN.5/2007/, 2007. Të dhënat në lidhje me OKB-në dhe përkufizimin për të rinjtë mund të lexohen në lidhjen: <http://www.un.org/esa/socdev/documents/youth/fact-sheets/youth-definition.pdf>
- EU Youth Strategy – Investing and Empowering 2010-2018 / Erasmus + and Youth in Action Programmes / Eurostat reports and Eurobarometer surveys.
- P. John, Analysing Public Policy, (1998) Continuum.
- Lëvizja Mjaft & Instituti Axhenda, (2012) *Rinia Shqiptare: Problemi apo Investimi i Shkëlqyer*, Tiranë. (Fq. 8)
- Shadow Report on Youth Policy, European Youth Forum, Brussels, 2015.
- Youth not in employment, education or training in Europe (NEET) 2014-2015, ILO statistics. Mund të aksesohet në link: http://www.ilo.org/ilostat/faces/oracle/webcenter/portalapp/pagehierarchy/Page3.jspx?MBI_ID=20
- Popullsia në Shqipëri, INSTAT 2018.
- SABER country report: Early childhood development, World Bank Group 2015.
- An Update on Poverty and Inequality in Albania: 9 Stylized Facts, Poverty Global Practice, World Bank 2015.
- The Learning Generation: Investing in Education for a Changing World, The International Commission on Financing Global Education Opportunity. 2016.
- EUROSTAT, Të dhëna mbi GDP-në në vendet kandidate, http://ec.europa.eu/eurostat/tgm/table.do?tab=table&init=1&plugin=1&pcode=sdg_08_10&language=en
- Arsimi në Shqipëri, INSTAT 2018.
- Puna në Shqipëri, INSTAT 2018.
- Migracioni dhe integrimi i migrantëve, 2017, INSTAT.
- Global Employment Trends for Youth 2015: Scaling up investments in decent jobs for youth / International Labour Office – Geneva: ILO, 2015
- Puna jonë me të Rinjtë, World Vision Shqipëri.
- Zëri i të Rinjve 2017, Save the Children Shqipëri.
- EUROSTAT, të dhëna mbi emigracionin në 28 vendet e BE-së. Link: http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Asylum_statistics
- Vjetari Statistikor 2017 i Ministrisë së Drejtësisë / Të dhëna të INSTAT për kriminalitetin dhe dënimet në Shqipëri 2018.